



Integrimi: Sfidat e bujqësisë lidhen me forcimin e zinxhirit nga fermeri te konsumatori

Faqe 11



Konferenca e 28-të e MFC në Durrës Sulaj: Mikrofinanca mbetet një instrument kyç për përfshirjen financiare

Faqe 2



Rama: Linjë kredie me interes minimal 2% për NVM-të

Faqe 6



AGROBIZNESI



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit maj 2026

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 534
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

INTEGRIMI - BE TRANSFORMIM OSE FALIMENT! FATURA PËR TRANSFORMIM DO TË PËRBALLOHET NGA BIZNESET

Shoqatat e bizneseve pohojnë njëzëri se procesi i integrimit të Shqipërisë në BE do të sjellë rritje të sigurisë ushqimore dhe formalizim tregu. Por njëkohësisht edhe mbyllje të bizneseve të papërgatitura. Shoqata e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë vlerëson se nga sondazhet e para, vetëm 15% e bizneseve janë të përgatitura për në BE, ndërsa rreth 98% e tyre nuk kanë mundësi financiare për të përbaluar vetë faturën e kostonë së transformimit

ALBANIA

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Toka bujqësore për të huajt, Qeveria bën gati draftin e ri, ja kushtet, zonat e ndaluara, limitet e blerjes dhe "vijat e kuqe"



Faqe 4

FINANCIM

BEI 20 milionë euro për mbështetjen e bizneseve shqiptare për inovacion dhe tranzicion të gjelbër

Faqe 4

SUBVENCION

Ibrahimaj: Të gatshëm të marrim masa shtesë nëse rriten më tej çmimet



Faqe 5

TEMA TË DITËS

- Mbi 53 milionë lekë dëmshpërblim për blegtorët e dëmtuar nga murtaja e ruminantëve Fq.4
- Malaj: Kredi të butë për SME-të, 30 milionë euro garanci sovraane për bizneset Fq.6
- Banka e Shqipërisë licencon zyrtarisht edhe degën e bankës turke Ziraat Fq.7
- Vaksinimi i bagëtive të imëta, veterinerët apelojnë për respektimin e protokolleve Fq.7
- Kajsia e Xibrakës - Prodhim i bollshëm pas 5 vitesh, fermerët kërkojnë mbështetje Fq.7

Faqe 4

BUJQËSI

Jaupllari në Konferencën e FAO-s: Fokus siguria ushqimore dhe zhvillimi rural

FED INVEST

Konferenca e 28-të e MFC në Durrës - Sulaj: Mikrofinanca mbetet një instrument kyç për përfshirjen financiare

Konferenca Vjetore e 28-të e Qendrës Ndërkombëtare të Mikrofinancës (MFC), me temë “Mikrofinanca në tranzicion: A është misioni në rrezik?”, po zhvillohet këtë vit në Durrës, nga data 19 deri më 21 maj, me pjesëmarrjen e rreth 500 përfaqësuesve të institucioneve financiare, organizatave ndërkombëtare, investitorëve dhe ekspertëve të mikrofinancës nga më shumë se 40 vende të rajonit, Europës dhe më gjerë. Konferenca MFC rikthehet në Shqipëri pas

10 vitesh, në një vit që përkon edhe me 100-vjetorin e Bankës së Shqipërisë dhe 20-vjetorin e AMA-s.

Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj, në fjalën e saj pershendetese trajtoi rolin e mikrofinancës në zhvillimin ekonomik dhe social, si dhe sfidat me të cilat përballlet ky sektor në një mjedis financiar dhe teknologjik në transformim.

“Misioni primar i mikrofinancës është të jetë një alternativë e përballeshme dhe një

mbështetje sociale për shtresat që kanë më tepër nevojë për një derë të hapur në sektorin financiar. Përtej dimensionit financiar, mikrofinanca duhet të kontribuojë në krijimin e mundësive për zhvillim, punësim dhe përfshirje ekonomike, duke ruajtur gjithmonë balancën mes objektivave tregtarë dhe përgjegjësive sociale”, u shpreh ajo.

Z. Perlat Sulaj, Drejtor Ekzekutiv i FED invest-it, si anëtar i Bordit të MFC-se dhe perfaqësues i AMA-s, mba-

ji fjalën kryesor në hapjen e konferencës dhe e vlerësoi këtë konferencë si ngjarjen me të rëndësishme të sektorit të mikrofinancës në Europë dhe në Azinë Qendrore.

Gjatë fjalimit ai vlerësoi rolin historik të mikrofinancës në Shqipëri që nga fillimi i epokës post-komuniste, duke ndihmuar mijëra individë dhe mikro-sipërmarrës të ndërtojnë aktivitetet e tyre ekonomike. Fale misionit të tyre social dhe zhvillimor këto institucione kontribuan në zgjerimin dhe

konsolidimin e mijera sipërmarrjeve, tashme financiarisht të pavaruara.

Ndër të tjera ai theksoi: “Sot ky sektor ka evoluar nga një sistem mbështetës me kredi të vogla për individët pa akses në banka, në një ekosistem të vërtetë të përfshirjes financiare, ku kanalet dixhitale po ulin kostot dhe po prekin thellë zonat rurale dhe komunitetet e pashërbyera me produkte të personalizuar me nevojat lokale”. Z. Sulaj u shpreh: “Ky mision madhor

në Shqipëri dhe rajon vazhdon të mbështetet fuqishëm me financime, garanci dhe programe zhvillimi nga institucione të fuqishme ndërkombëtare si Komisioni Europian, Fondi Europian i Investimeve, Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës, EFSE etj.

Organizatorët theksuan se konferenca evidenton angazhimin e përbashkët për ta mbajtur mikrofinancën një nga instrumentet më të fuqishme për progresin njerëzor dhe përfshirjen ekonomike.



Rodríguez-Pose: Shqipëria ka kapacitete dhe potencial për zhvillimin e modeleve të qëndrueshme ekonomike



Shqipëria duhet të fokusohet në shfrytëzimin e potencialit të saj të brendshëm, zhvillimin e talenteve dhe përshtatjen e modeleve të suksesshme ndërkombëtare me realitetin vendas, në mënyrë që të ndërtojë një ekonomi të qëndrueshme dhe inovative, u shpreh profesori i njohur i London School of Economics (LSE), Andrés Rodríguez-Pose, gjatë Konferencës Vjetore të 28-të të Qendrës Ndërkombëtare të Mikrofinancës (MFC) në Durrës.

I pranishëm në aktivitet, në një intervistë për mediet, ai vlerësoi se vendi ka kapacitete të konsiderueshme njerëzore dhe zhvillimore, të

e pashfrytëzuar”, u shpreh Rodríguez-Pose.

Ai theksoi se zhvillimi nuk duhet të bazohet në kopjimin e modeleve të gatshme nga vende të tjera, por në përshtatjen e tyre me realitetin lokal dhe në përdorimin më efikas të burimeve ekzistuese.

“Ky potencial duhet të përdoret jo për të vazhduar të njëjtën gjë, por përmes përdorimit të burimeve, financimeve dhe trajnimeve, në mënyrë që të shndërrohet në diçka të re dhe më transformuese”, tha ai.

Sipas profesorit të LSE, një nga rreziqet kryesore për vendet në zhvillim është imitimi i modeleve të huaja, i cili shpesh

është të bardhë: komplekse të mëdha dhe infrastrukturë që janë të shkëputura nga ekonomia lokale”, deklaroi ai.

Rodríguez-Pose theksoi se Shqipëria duhet të mësojë nga përvojat ndërkombëtare, por pa i kopjuar ato mekanikisht, duke i përshtatur me potencialin e vet zhvillimor dhe duke u fokusuar në transformimin e sektorëve ekzistues.

Duke folur për rolin e institucioneve, ai nënvizoi se zhvillimi ekonomik nuk mund të arrihet vetëm përmes financimeve, por kërkon reforma të thella dhe funksionim të qëndrueshëm institucional.

“Institucionet janë themelore

të forcojë besimin në sistemin institucional, duke garantuar funksionimin e shtetit të drejtë dhe mbrojtjen e pronës private.

“Është e domosdoshme që qytetarët dhe investitorët të mund t'i besojnë sistemit, gjykatave, policisë, bizneseve dhe njerëzve vendas, në mënyrë që të krijohen lidhje të qëndrueshme”, u shpreh ai.

Profesori i LSE shtoi gjithashtu se nevojitet rritje e efikasitetit të administratës publike, trajnimi i zyrtarëve dhe ulja e korrupsionit në nivele të krahasueshme me standardet evropiane.

Rodríguez-Pose është një nga ekspertët më të njohur

Rodríguez-Pose u ndal tek ajo që ai e quan “gjeografia e ekonomisë”, duke analizuar pse disa vende dhe rajone arrijnë të zhvillohen me shpejtësi, ndërsa të tjera mbeten të bllokuara në stanjacion ekonomik dhe social. Sipas tij, zhvillimi nuk lidhet vetëm me kapitalin apo investimet, por edhe me cilësinë e institucioneve, aftësinë për të ndërtuar besim social, inovacionin dhe përfshirjen territoriale. Ai argumentoi se shumë rajone në Europë dhe më gjerë kanë mbetur pas jo sepse u mungojnë burimet, por sepse kanë dështuar të krijojnë modele zhvillimi që shpërndajnë mundësitë në mënyrë të drejtë. Në këtë kontekst, ai paralajmëroi se tranzicioni teknologjik dhe transformimi digjital mund të thellojnë më tej pabarazitë, nëse sistemet financiare dhe politikat publike nuk fokusohen tek përfshirja dhe zhvillimi lokal

cilat ende mbeten pjesërisht të pashfrytëzuara, duke theksuar nevojën për politika që i kthejnë këto burime në motor zhvillimi.

“Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm, ka shumë talent, dhe një pjesë e madhe e këtij talenti aktualisht mbetet

nuk përputhet me nevojat reale të ekonomisë vendase.

“Ajo që ka qenë normë në shumë vende, si të mëdha ashtu edhe të vogla, është ideja se mund të imitosh modelet e vendeve në pararojë të transformimit. Por kjo shpesh përfundon në atë që quajmë ‘ele-

për zhvillimin ekonomik. Zhvillimi nuk ndodh thjesht duke hedhur para”, tha ai, duke shtuar se edhe mbështetja e Bashkimit Europian “nuk do të bëhet fjalë vetëm për financime, por edhe për reforma institucionale”.

Sipas tij, Shqipëria duhet

ndërkombëtarë në fushën e zhvillimit ekonomik dhe pabarazive rajonale, me bashkëpunime me institucione si Komisioni Europian, Banka Botërore dhe OECD, ndërsa puna e tij akademike konsiderohet ndër më të cituarat në këtë fushë.

INTERVISTË

INTEGRIMI - BE TRANSFORMIM OSE FALIMENT!

FATURA PËR TRANSFORMIM DO TË PËRBALLOHET NGA BIZNESET

Shoqatat e bizneseve pohojnë njëzëri se procesi i integrimit të Shqipërisë në BE do të sjellë rritje të sigurisë ushqimore dhe formalizim tregu. Por njëkohësisht edhe mbyllje të bizneseve të papërgatitura. Shoqata e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë vlerëson se nga sondazhet e para, vetëm 15% e bizneseve janë të përgatitura për në BE, ndërsa rreth 98% e tyre nuk kanë mundësi financiare për të përballuar vetë faturën e koston së transformimit

Nga retorika politike, çështja e integrimit europian ka nisur të hyjë në fazën e vlerësimeve për përmbushjen e kushteve të sigurisë. Të parët që duhet të kalojnë testimin janë 904 operatorë të produkteve ushqimore.

Fatura për transformim do të përballohet nga bizneset

Flet Agim Rrapaj

Kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar

Deri tani duket se fatura e investimeve për përmbushjen e standardeve të Bashkimit Europian do të përballohet vetë nga bizneset. Agim Rrapaj, kryetar i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, thotë se mungesa e kapaciteteve financiare mbetet pengesa kryesore për bizneset që duhet të investojnë në standarde sigurie ushqimore apo teknologji moderne, për të mos rrezikuar daljen nga tregu. Z. Rrapaj thotë se fondet që do të përdoren mund të gjenden përmes disa burimeve për kreditim me kushte lehtësuese nga Garancitë Sovrane me norma interesi 2% apo grantet e programit IPARD III.



A janë bizneset bujqësore në vend të përgatitura për certifikim sipas standardeve të Bashkimit Europian, pra për të hyrë drejt tregjeve europiane? A kanë ato kapacitetet financiare dhe teknike për ta arritur këtë?

Subjektet prodhuese dhe përpunuese, pa përjashtim, që prodhojnë për treg janë të detyruara të plotësojnë kriteret e sigurisë ushqimore.

Bujqësia, blegtoaria, peshkimi dhe akuakultura, agropërpunimi, agrobiznesi (qendrat e grumbullimit), agroturizmi (bujtinat), bletaria, bimët mjekësore dhe aromatike, frutat e pyllit, si dhe prodhuesit e farërave dhe fidanëve – të gjitha subjektet që operojnë në sektorët e sipërpërmendur duhet të plotësojnë kriteret e Bashkimit Europian për sigurinë ushqimore.

Subjektet e biznesit bujqësor shqiptar nuk kanë pasur një ligj apo rregulla specifike për standardet. Ato kanë dalë në treg me produktet e tyre me standarde sipas dëshirës dhe mundësive. BE ka ligje dhe direktiva specifike të detyrueshme për t'u zbatuar për tregtimin e produkteve në treg. Subjektet bujqësore shqiptare, me hyrjen në BE, duhet detyrimisht të prodhojnë dhe tregtojnë produktet e tyre, jo vetëm në tregjet e BE-së, por tashmë edhe në tregun shqiptar, duke respektuar rigorozisht ligjet dhe direktivat e BE-së për standardet.

Zbatimi i standardeve të detyrueshme kërkon njohjen dhe zbatimin e direktivave të BE-së, si dhe kapacitete teknike e financiare shtesë nga subjektet bujqësore, që të mund të respektojnë standardet dhe të shesin prodhimet e tyre. Shumica e subjekteve bujqësore nuk i kanë këto kapacitete teknike

dhe financiare, por do të jenë të detyruara t'i gjejnë, sepse nuk do të lejohen të dalin në treg të shesin prodhimet e tyre as në tregun e vendit, as në atë të BE-së.

Në vend janë 354 mijë prodhues të produkteve bujqësore dhe blegtorale, që kanë tokë për të prodhuar. Nga ky total, rreth 110 mijë kanë të drejtë të tregtojnë prodhimet e tyre sipas kriterëve të vendit. Pra janë subjekte të pajisur me NIPT, përfshirë bujq, fermerë, peshkatarë, bujtina dhe agropërpunues që prodhojnë për tregun.

Të gjithë këto biznese duhet të grupohen në njësi shërbimi dhe të organizohen si organizata prodhimi, të bashkëpunojnë në modele si ato të Zvicrës, Japonisë, Izraelit, Italisë etj., në mënyrë që të arrijnë të plotësojnë kriteret për certifikim të standardeve sipas BE-së.

Nga vlerësimet e para, realizuar përmes verifikimeve në terren në biznese, si: thertore, te përpunuesit e qumështit (fabrika dhe baxho), bujtina, si dhe në sektorin e agropërpunimit (konservimi i perimeve të grira, konservat, ushqimet me origjinë blegtorale) janë dhënë rekomandime, kryesisht për përmirësimin e standardeve për asgjësimin e mbetjeve në thertore, për metodat e analizave në laboratorë dhe mënyrën se si do të kryhen ato, si dhe për certifikimin e cilësisë së produkteve. Për bujtinat, rekomandimet janë fokusuar te përmirësimi i sistemeve të mbrojtjes nga zjarri. Shumë prej tyre kanë rezultuar me dritare të vogla, që rrisin rrezikun për jetën në rast rënie zjarri.

Po ashtu janë edhe rreth 300–400 subjekte eksportuese, përfshirë qendrat e grumbullimit dhe eksportit që plotësojnë kushtet e sigurisë ushqimore sipas standardeve të BE-së. Edhe ky grup mund të ketë probleme që kanë nevojë të përmirësohen, por e përballojnë koston e investimeve për përmbushjen e këtyre standardeve.

Përveç kësaj, te bizneset ka mungesë informacioni për investimet dhe fondet që do të përdoren për arritjen e standardeve. Si është parashikuar të vepronë, ku do të fokusohen investimet e tyre, çfarë fonde do të përdorin, do të ketë financim nga shteti apo nga BE?

Informacioni për standardet e detyrueshme të BE-së për bizneset bujqësore shqiptare ka filluar të jepet, por ka mungesë ndërjegjësimi për veprim të menjëhershëm prej tyre për të vendosur e për të vepruar pa humbur kohë për përmirësimin e teknologjisë. Fondet që do të përdoren për këtë proces mund të gjenden përmes disa burimeve si p.sh.: kredia me kushte lehtësuese prej 250 milionë eurosh, me interes 2%, shoqëruar me garancinë sovranë prej 30 milionë eurosh, që ka akorduar qeveria shqiptare për ato subjekte që nuk plotësojnë kolateralin e kërkuar nga bankat e nivelit të dytë; granti i dhënë për skemën kombëtare të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural prej 52 milionë eurosh; granti i programit IPARD III prej 146 milionë eurosh; kredi nga Banka Shqiptare e Zhvillimit dhe nga bankat e nivelit të dytë; fonde nga aktiviteti financiar i vetë subjekteve; fonde nga disa projekte pilot të financuara nga donatorët si GIZ, BB, BERZH, BEI etj.

Sa është afati i lejuar i biznesit për përmbushjen e këtyre standardeve?

Afatet për plotësimin e standardeve për sigurinë ushqimore kanë filluar me kohë. Në momentin që Shqipëria anëtarësohet në BE, standardet për sigurinë ushqimore duhet të jenë plotësuar. Periudha që teorikisht është në dispozicion të bizneseve bujqësore shqiptare për të përmbushur kërkesat e standardeve është shumë e shkurtër, 4–5 vjet.

Në të kundërt, çfarë parashikohet të ndodhë me bizneset që nuk do të arrijnë të përmbushin kërkesat ligjore?

Bizneset bujqësore, që nuk do të përmbushin kërkesat e detyrueshme të standardeve, sipas direktivave të BE-së, nuk do të mund të shesin produktet e tyre as në tregun e vendit, as në atë të BE-së. Kur produkti nuk ka treg për shitje, prodhuesi ose do të ndërpresë prodhimin, ose do të falimentojë. Situata është bërë e qartë edhe në takimin e datës 21 prill 2026, ku morën pjesë kryeministri Edi Rama, kryenegociatorja Majlinda Dhuka, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, ambasadori i BE-së, Silvio Gonzatto, Inspektori i Përgjithshëm, Dashnor Sula, drejtues të institucioneve shtetërore të ngarkuara për kontrollin e zbatimit të direktivave për standardet e sigurisë ushqimore, përfaqësues të shoqatave dhe subjekteve agroushqimore etj.

Si do të vepronë institucionet shtetërore për t'i ardhur në ndihmë biznesit, apo do të fokusohen investimet në ngritjen e infrastrukturës dhe të një sistemi kombëtar funksional dhe efektiv për kontrollin e zinxhirit "nga ferma në tavolinë"?

Përfaqësuesit e institucioneve shtetërore në takimin e datës 21 prill 2026 premtuan se do të punojnë krah për krah me subjektet e bizneseve bujqësore për të mundësuar plotësimin brenda afatit të kushteve dhe kriterëve që kërkojnë nga BE për standardet e sigurisë ushqimore. U premtua që do të hapej IPARD III brenda vitit 2026, do të hapej një program i ri financimi me kushte lehtësuese me objektivin "Dyfisho ndërmarrjen tënde", brenda vitit 2026 do të fillonte aktivitetin Banka Shqiptare e Zhvillimit, u përsëritën burimet e financimit të përmendura më sipër, do të përmirësohej sistemi i laboratorëve dhe procesi i gjurmueshmërisë. Ambasadori Gonzatto premtoi se BE do të asistojë si teknikisht, ashtu edhe financiarisht etj.

A ka qenë e mjaftueshme ndër vite mbështetja që buxheti i ka dhënë bujqësisë për të siguruar vetëmjaftueshmërinë ushqimore, duke qenë se importet mbeten të larta?

Mbështetja buxhetore e sektorit të bujqësisë, duke e vlerësuar në këndvështrimin e plotësimin të nevojave minimale, ka nevojë edhe për 96 milionë euro të tjera. E vlerësuar dhe krahasuar me rajonin tonë (Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia), financimi nga buxheti është ndjeshëm më i vogël. Disproporcioni në financim dhe paketa fiskale e padobishme ndikojnë negativisht te koston dhe raportin import–eksport, duke krijuar kushte për favorizim të importit dhe konkurrencë të pandershme në treg.

Po mungesa e konkurrueshmërisë në sektorin bujqësor krahasuar me vendet e rajonit, ku subvencionet janë më të larta, si po ndikon në garantimin e sigurisë ushqimore në zinxhirin e furnizimit?

Konkurrenca e pandershme ndikon negativisht në reduktimin e prodhimit, tregues që është reflektuar kohët e fundit pothuaj në të gjithë sektorët e ekonomisë së ushqimit, përfshirë edhe eksportin, i cili për një periudhë kohe eci me ritme pozitive duke u rritur nga viti në vit. Gjithashtu ndikon negativisht në reduktimin e investimeve dhe krijon vështirësi në tregjet me vlerë të lartë, duke mos plotësuar kushtet për garantimin e standardeve të sigurisë ushqimore. Konkurrenca e pandershme, e shoqëruar edhe me informalitetin e lartë, i çon drejt falimentit subjektet që punojnë në ekonominë e ushqimit dhe jo vetëm.

AKTUALITET

Mbi 53 milionë lekë dëmshpërblim për blegtorët e dëmtuar nga murtaja e ruminantëve

Këshilli i Ministrave miratoi dëmshpërblimin për blegtorët, kafshët e të cilëve janë prekur nga sëmundja e murtajës së ruminantëve të vegjël gjatë vitit 2025.

Sipas vendimit, masa totale e dëmshpërblimit arrin në 53 345 500 lekë dhe do t'u shpërndahet pronarëve të kafshëve që janë therur, eliminuar, shkatërruar ose groposur pas konfirmimit pozitiv të sëmundjes nga analizat e kryera nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Vendimi parashikon që fondi i dëmshpërblimit të përballohet nga buxheti i vitit 2026, i miratuar për

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të programit buxhetor "Siguri

Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së



ria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit".

Për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar Ministria e

Bimëve.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

Jaupllari në Konferencën e FAO-s: Fokus siguria ushqimore dhe zhvillimi rural

Shqipëria po merr pjesë në Sesionin e 35-të të Konferencës Rajonale të FAO për Europën (ERC35), që zhvillohet në Dushanbe, Tashkistan, forumi më i lartë drejtues i FAO-s për Europën dhe Azinë Qendrore.

Delegacioni shqiptar kryesohet nga zv.ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Arian Jaupllari, i cili në fjalën e mbajtur e vuri theksin në piketat kryesore që po ndërmerren qeveria për forcimin e sigurisë ushqimore sipas standardeve europiane dhe politikave të reja në mbështetje të zhvillimit rural.

Në konferencë marrin pjesë ministri dhe përfaqësues të lartë nga vendet e rajonit, të cilët po diskutojnë prioritetet për ndërtimin e sistemeve agrourbane të qëndrueshme, rritjen e sigurisë ushqimore, përbalimin

e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin rural gjithëpërfshirës.

Shqipëria, anëtare e FAO-s

mbrojtjen e burimeve natyrore dhe përafrimin me standardet e Bashkimit Europian.



prej vitit 1973, vijon angazhimin për transformimin e sektorit agrourban drejt modeleve më të gjelbra dhe të qëndrueshme, në mbështetje të fermerëve dhe komuniteteve rurale, si dhe për

Gjithashtu, Zyra e FAO-s në Shqipëri mbështet institucionet shqiptare në rrugëtimin drejt sistemeve agrourbane më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

BEI 20 milionë euro për mbështetjen e bizneseve shqiptare për inovacion dhe tranzicion të gjelbër

Në Tiranë, u nënshkrua marrëveshja për një linjë të re financimi me vlerë 20 milionë

shqiptare në inovacion, digjitalizim, teknologji dhe investime të gjelbra.

tesa Sanpaolo Bank Albania.

Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Delina Ibrahimaj, si dhe presidentja e Bankës Europiane të Investimeve, Nadia Calviño.

Marrëveshja prej 20 milionë eurosh ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania synon të mbështesë bizneset e vogla dhe të mesme në Shqipëri përmes financimeve të favorshme për inovacion, digjitalizim, teknologji dhe investime të gjelbra.

Marrëveshja u vlerësua nga përfaqësuesit e BEI-së dhe qeverisë shqiptare si një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të ekonomisë, rritjes së konkurrueshmërisë dhe përafrimit me standardet e Bashkimit Europian.

Marrëveshja u nënshkrua nga Roberto Crod, zëvendës-president i Bankës Europiane të Investimeve, dhe Giuseppe Janpiero, drejtor i In-



euro ndërmjet Bankës Europiane të Investimeve (BEI) dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, me qëllim mbështetjen e bizneseve të vogla dhe të mesme

Toka bujqësore për të huajt, Qeveria bën gati draftin e ri, ja kushtet, zonat e ndaluara, limitet e blerjes dhe "vijat e kuqe"

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit me Bashkimin Evropian dhe plotësimit të detyrimeve për Kapitullin 4, "Lëvizja e lirë e kapitalit", Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hartuar një projektligj të ri që do të lejojë blerjen e tokës bujqësore nga personat fizikë dhe juridikë të huaj. Ky hap historik për pronësinë në Shqipëri synon të thithë investime të huaja, por vjen me filtra të rreptë për të mbrojtur pasurinë kombëtare.

Deri më sot, ligji shqiptar nuk e lejonte shitjen e tokës bujqësore të të huajt, duke u ofruar atyre vetëm mundësinë e qiradhënies deri në 99 vjet. Me ligjin e ri, i cili është i domosdoshëm për të përmbushur Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit (MSA), ky treg pritet të hapet, duke ofruar një potencial të madh për zhvillimin e agrobiznesit.

"Ky ligj synon të garantojë balancë mes interesit publik kombëtar dhe nxitjes së investimeve të huaja në bujqësi, duke mbrojtur tokën si pasuri dhe burim strategjik kombëtar," theksohet në relacionin shpjegues të draftit, firmosur nga Ministri i Bujqësisë, Andis Salla.

Sipas dokumentit, objekt i këtij ligji do të jenë rreth 100 mijë hektarë tokë bujqësore e pandarë, si dhe 25 mijë hektarë tokë "disponibël shtetëror" që ka origjinën nga

ish-Ndërmarrjet Bujqësore.

Filtri "antimonopol", sa tokë mund të blihet?

Për të shmangur përqendrimin e tokës në pak duar dhe dominimin ekonomik nga të huajt, projektligji ka parashikuar një mekanizëm të fortë kufizues. Investitorët e huaj nuk do të mund të blejnë sipërfaqe të pakufizuara.

"Në këtë ligj është përcaktuar për personat fizikë dhe juridikë të huaj e drejta e blerjes për një sipërfaqe prej 2 hektarësh brenda të njëjtës bashki, si dhe deri në 30 hektarë në shkallë Republike. Ky përcaktim përbën njëkohësisht një instrument 'antimonopol' mbi tokën bujqësore," sqaron Ministria në relacionin e saj.

Për të përfituar këtë të drejtë, të huajt duhet të përmbushin kriteret specifike, si banimi afatgjatë në Shqipëri dhe zotërimi i një leje të posaçme për veprimtari bujqësore.

"Vijat e Kuqe", ku nuk mund të ndërtohet apo blihet?

Ligji i ri ka vendosur barrierat të pakapërcyeshme për zona të caktuara, me qëllim ruajtjen e sigurisë kombëtare dhe trashëgimisë. Ndalohet rreptësisht kalimi i pronësisë së tokës nëse ajo ndodhet në zona me rëndësi

strategjike dhe ushtarake; parqe kombëtare dhe rezervate të florës e faunës; zona me rëndësi historike apo arkeologjike; prona që janë ende objekt i procesit të kthimit dhe kompensimit të ish-pronarëve.

Për më tepër, drafti vendos detyrime strikte pas blerjes:

"Të huajt duhet ta përdorin tokën vetëm për veprimtari bujqësore dhe blegtorale. Ndalohet rreptësisht ndryshimi i kategorisë ose destinacionit të përdorimit të tokës," paralajmëron dokumenti, duke theksuar se çdo shkelje do të përballet me ligjin.

Kur do të nisë zbatimi?

Edhe pse projektligji pritet të kalojë për miratim gjatë vitit 2026, efektet e tij nuk do të jenë të menjëherëshme. Në nenin 12 të draftit është përcaktuar një klauzolë mbrojtëse kohore mjaft e rëndësishme: ligji do t'i shtrijë efektet e tij vetëm 7 vjet pas anëtarësimit të plotë të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Deri atëherë, institucionet shqiptare (Ministria e Bujqësisë, Bashkitë, ASHK dhe Ministria e Brendshme) do të duhet të ngrënë infrastrukurën e nevojshme të kontrollit për t'u siguruar që ky proces të jetë transparent dhe në shërbim të ekonomisë vendase.

Helmimi i studentëve, AKU: Ndërpritet aktiviteti i subjektit Sori-AL, makaronat me baktere mbi normë



Për shkak të këtyre gjetjeve, AKU vendosi ndërprerjen e aktivitetit të kompanisë Sori-AL, deri në plotësimin e kërkesave ligjore për pastrimin dhe dezinfektimin e ambienteve dhe pajisjeve të punës.

Gjithashtu, në kuadër të gjurmueshmërisë, u verifikua edhe prodhimi në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", pranë Forcave të Armatosura.

Raportet e institucioneve shëndetësore evidentuan rezultate jo konform treguesve të higjienës në kampionët e ruajtur dhe në disa pajisje pune.

Si rezultat, AKU ndërpreu aktivitetin edhe në këtë subjekt, dhe vendosi një gjobë administrative prej 1.500.000 lekësh për ushqim të pasigurt dhe kushte higjieno-sanitare të papërshtatshme.

"Në vijim të ndjekjes së gjurmueshmërisë, në adresën

Garnizoni "Skënderbej" pranë Forcave të Armatosura, ku është kryer prodhimi i këtyre produkteve, referuar konstatimeve të institucioneve shëndetësore, mbi raportin përfundimtar të hetimit epidemiologjik për rezultatet jokonforme për tregues të higjienës, evidentuar në kampionët në ruajtje si dhe në disa prej pajisjeve të punës, AKU mori masa për ndërprerjen e aktivitetit të subjektit SORI-AL edhe në adresën Garnizoni "Skënderbej" pranë Forcave të Armatosura. Gjithashtu u vendos masë administrative me gjobë në vlerën 1.500.000 lekëve për ushqim të pasigurt dhe kushte higjieno-sanitare", bën të ditur AKU.

Subjektit iu la detyrë të kryejë procedurën e asgjësimit të produktit të bllokuar, i cili ishte konstatuar jo konform ligjit.

POLITIKË FISKALE

Ibrahimaj: Të gatshëm të marrim masa shtesë nëse rriten më tej çmimet

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj foli në Kuvend mbi masat që ka marrë qeveria për të përballuar rritjen e çmimeve të shkaktuara nga situata e konfliktit në Lindjen e Mesme dhe ndikimi i saj në tregjet ndërkombëtare.

Ibrahimaj iu përgjigj interpelancës së kërkuar në Kuvend nga deputeti i Partisë Demokratike, Enno Bozdo lidhur me këtë çështje.

rrizikojnë stabilitetin makroekonomik. Kemi zgjedhur të reagojmë me qetësi dhe me përgjegjësi, me monitorimin e tregut, me transparencë, me mbështetje të targetuar dhe në mbrojtje të ekuilibrave ekono-

kishte spekulime me rritjen e çmimeve të karburanteve, me çmime të cilat tejkalonin rritjen e çmimeve ndërkombëtare, por edhe spekulime me rritjen e çmimeve të tjera”, shtoi ajo.

Po ashtu, sipas ministres nën monitorim janë edhe çmimet e të gjithë produkteve të shportës së konsumit.

Ibrahimaj u ndal edhe të aktivizimi i Bordit të Transparencës për karburantet, i cili vendos çmimet tavan dhe kontrollon marzhet e tregtimit me shumicë dhe me pakicë, duke siguruar që luhatjet e bursës të reflektohen në mënyrë të drejtë dhe pa hapësirë për spekulim.

“Rritja në bursat ndërkombëtare për karburantet është diku tek 67% deri në 87% që nga fillimi i krizës. Sigurisht, ne analizën e bëjmë nga periudha para krizës, sepse duam të kuptojmë efektet e krizës. Ndërkohë, në tregun vendas, rritja e çmimit të karburantit ka qenë shumë më e moderuar. Sipas të dhënave të INSTAT, çmimi i naftës është rritur mesatarisht me 18 deri në 21% gjatë muajve mars dhe prill 2026, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë”, shtoi Ibrahimaj.

Ibrahimaj theksoi se në krizën aktuale, ndërhyrja është përqendruar te karburantet, te transporti publik, te monitorimi i tregut dhe transparenca.

“Diferenca mes rritjes ndërkombëtare dhe rritjes në tregun vendas vjen si rezultat i ndërhyrjeve që ne kemi bërë, i dialogut me operatorët, i monitorimit të përditshëm dhe i kufizimit të hapësirës për abuzim. Nëse qeveria nuk do të kishte ndërhyrë, rritja ndërkombëtare do të ishte pasqyruar më shumë në tregjet lokale dhe në çmimin final për qytetarët. Pikërisht për këtë arsye ne gjykojmë që masat e marra kanë pasur një rezultat konkret”, shtoi ajo.

mikë të vendit”, tha ajo.

Detyra kryesore e qeverisë, sipas Ibrahimajt “është ruajtja e stabilitetit”.

“Në situata të tilla rreziku, ne jemi kujdesur që të monitorojmë rritjen e kostove dhe gjithashtu të monitorojmë tentativat për panik dhe për spekulim. Pikërisht për këtë arsye, ndërhyrja e shtetit përmes monitorimit dhe transparencës, në gjykimin tonë, është thelbësore. Gjatë muajve të kaluar, që prej fillimit të luftës dhe tensioneve në Lindjen e Mesme, apo bllokimit të Kanalit të Hormuzit, ngritëm menjëherë një komunikim të drejtpërdrejtë me furnizuesit e karburanteve në vend, për të vlerësuar gjendjen e rezervave dhe zinxhirin e furnizimit”, shtoi ajo.

Së pari Ibrahimaj theksoi se qeveria u siguroi se nuk kishte rrezik lidhur me zinxhirin e furnizimit të karburanteve në vend. “Ngritëm disa grupe nga institucione të ndryshme për monitorimin e tregut, në mënyrë që të monitoronim nëse do të

Në tërësi, sipas ministres Ibrahimaj, masat e marra ishin të kujdesshme, jo të nxituara, të marra në kohën e duhur, ishin masat e duhura për strukturën ekonomike që ka vendi”.

“Shqipëria, në muajin prill 2026, ka një inflacion prej 2.8%, që për të gjithë ekonomistët në sallë do të thotë se është një inflacion i cili është afër targetit të Bankës së Shqipërisë, që do të thotë se është një inflacion i cili garanton një zhvillim ekonomik afër potencialit që ekonomia ka. Në muajin mars inflacioni ishte 2.6%, në muajin shkurt 2.5% dhe në janar 2.3%. Shqipëria, në muajin prill, renditet ndër vendet që ka inflacionin më të ulët në Ballkanin Perëndimor dhe në Europën Juglindore”, theksoi ajo.

Për krahasim, Ibrahimaj theksoi se në të njëjtin muaj, inflacioni në Serbi ishte 3.3%, në Mal të Zi 3.8%, 5.7% në Maqedoninë e Veriut, 5.4% në Greqi, 5.8% në Kroaci dhe 10.7% në Rumani. Italia ishte në të njëjtin nivel me Shqipërinë, 2.8%, ndërsa Franca ishte 2.2%.

“Kjo tregon që Shqipëria ka ruajtur një mjedis çmimesh relativisht më të qëndrueshëm se shumica e vendeve të rajonit dhe disa vende të Bashkimit Europian. Shqipëria ka pasur një ecuri gjithashtu të mirë të inflacionit të ushqimeve”, tha Ibrahimaj.

Lidhur me propozimet e opozitës për të dhënë subvencione, Ibrahimaj theksoi se “e vërteta është se inflacioni i ushqimeve në shkurt ishte 1.6%, në mars 1.1% dhe në prill 1.2%”.

“Këto janë të dhënat zyrtare të Institutit të Statistikave dhe këto nivele janë ndjeshëm më të ulëta se në disa vende të Bashkimit Europian, ku presionet ndaj rritjes së çmimit të ushqimeve kanë qenë më të larta”, tha ajo.

Sa i takon energjisë elektrike, Ibrahimaj theksoi se “Shqipëria paraqitet me një

ecuri të qëndrueshme për konsumatorët, ndërkohë që treguesit e energjisë elektrike tregojnë për një reduktim të çmimit të energjisë elektrike”.

“T’i rikthehem shportës së konsumit: pesha e ushqimeve është 31.3%, transporti 6.4%, karburantet për transport personal janë 3.5% dhe energjia elektrike 4.9%. Këto janë shifra të cilat tregojnë dhe ndikojnë politikën që ne duhet të ndërmarrim dhe ku duhet të kemi kujdes, me qëllim që, në fakt, ajo që paralajmërohet nga rritja e çmimit të karburanteve, kur të ndodhë, ne të jemi në alert dhe të vërteta është që çmimet e ushqimeve nuk janë rritur. Inflacioni është nën targetin e Bankës së Shqipërisë dhe rritja e çmimeve ka qenë më e moderuar sesa në vendet e rajonit”, tha ajo.

Ibrahimaj theksoi se qeveria ka marrë masa dhe politika me qëllim që të garantojë që inflacioni të mos gërryëjë të ardhurat e qytetarëve shqiptarë.

“Ekonomia shqiptare ka pasur një rritje pozitive. Ne kemi treguar kapacitet në menaxhimin e krizave dhe prandaj nuk nxitohet për të thënë se do të japim kaq milionë subvencione apo do të reduktojmë kaq taksa, kur situata aktuale, përveç çmimeve të karburanteve, nuk është në gjendjen që të kemi subvencione të tjera. Nuk kemi prituri periudha krizash për të ndikuar në të ardhurat e qytetarëve, por kemi garantuar një politikë mbështetëse e cila ka qenë konstante, ku vit pas viti kemi pasur rritje të pagave dhe të pensioneve”, tha ajo.

Për sa i takon të dhënave të biznesit, Ibrahimaj theksoi se “të dhënat e aktivitetit ekonomik të muajve të parë të vitit tregojnë për një përmirësim të situatës ekonomike të bizneseve, duke u nisur nga xhiroja e bizneseve,

nga importet, nga tregtia, por edhe nga vetë numri i bizneseve të reja të regjistruara”.

“Vetëm për dy muajt e parë të vitit kemi 3760 biznese të reja të regjistruara, ose 14.6% më shumë se një vit më parë. Qarkullimi total për tremujorin e parë të vitit është rritur me 8.1%. Në periudhën janar-mars, sektori i tregtisë u rrit me 3.8%. Punësimi gjithashtu ka ardhur në rritje. Importet e kategorisë “ushqim, pije, duhan” kanë ardhur në rritje me 4.3% në vlerë dhe me 19.1% në vëllim. Ky është një tregues që, në fakt, përafrohet të dhënat mbi konsumin, që tregon se konsumi i familjeve shqiptare ka ardhur në rritje”, tha Ibrahimaj.

Në përfundim, Ibrahimaj theksoi se nëse zhvillimet ndërkombëtare do të përkeqësohen, ne jemi të gatshëm që të marrim masa shtesë, siç kemi bërë edhe në të kaluarën.

“Por deri më sot faktet janë këto: çmimet ndërkombëtare të naftës janë rritur më shumë sesa çmimet në tregun vendas. Inflacioni mbetet i moderuar. Inflacioni ushqimor mbetet në nivele më të ulëta dhe, në disa raste, në rënie të ritmit të rritjes në krahasim me vitin e kaluar. Transporti publik është subvencionuar nga qeveria, duke ndikuar në mosrritjen e kostos, dhe dua të kujtoj që transportin publik, në fakt, e përdorin ato shtesa të cilat janë më në nevojë”, tha ajo.

Sipas Ibrahimaj, çdo masë e re sociale do të aktivizohet menjëherë nëse vihet re që të ardhurat e familjeve shqiptare do të preken.

“Qeveria, sigurisht, nuk do të rrijë duarkryq nëse situata përkeqësohet, por ndërhyrjet e panevojshme, kur tregu funksionon, janë keqmenaxhim i burimeve publike. Pra, nëse pyetja është: a është qeveria që po e krijon apo po e shkallëzon krizën? Përgjigjja është Jo. Dhe nëse pyetja është: a po e përdor opozita këtë krizë për kapital politik? Përgjigjja është Po”, tha Ibrahimaj.

Investimet në ujitje e kullim vijojnë, përfundojnë punimet në kanalin K-1 në Kurbin

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural vijon investimet në sistemin e ujitjes dhe kullimit në të gjithë vendin, si për ndërtimin e veprave të reja, ashtu edhe për rehabilitimin dhe pastrimin e atyre ekzistuese.

Këto ndërhyrje synojnë garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemeve, duke iu përgjigjur nevojave për vaditje në bujqësi gjatë sezonit të thatë, por edhe për kullimin e tokave në periudhat me reshje intensive.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla bëri të ditur se aktualisht ekipet e Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit janë në terren dhe kanë përfunduar punimet në kanalin kullues K-1 në bashkinë e Kurbin.

Salla ndau në rrjete sociale momente nga puna që po kryhet aktualisht në këtë vepër ujitëse, teksa bëri të ditur se, “me gjatësi 7,8 km, zhvendosja e rreth 25 mijë m³ dherave përmirëson kullimin e mbi 1500 ha tokë bujqësore dhe zo-

nave të banuara”.

“Këto investime janë thelbësore për rritjen e produktivitetit në bujqësi dhe mbrojtjen e tokave nga përmytjet, duke garantuar kushte më të mira për fermerët në të gjithë vendin”, tha Salla.



Përgatitjet për sezonin e vaditjes, pastrohen kanalet dhe rrugët midis parcelave në Sarandë

Në Bashkinë e Sarandës kanë nisur ndërhyrjet për përgatitjen e sezonit të vaditjes, pas përfundimit të mbjelljes së kulturave kryesore bujqësore. Sipas drejtorit të bujqësisë, Mustafà Lama, puna në terren ka përfshirë pastrimin e kanaleve vaditëse dhe përmirësimin e infrastrukt-

turës mbështetëse për fermerët.

“Pas pastrimit të kanaleve vaditëse presim të korra të mbara”, u shpreh Lama.

Autoritetet lokale theksojnë se këto ndërhyrje janë të rëndësishme për garantimin e një sezoni vaditjeje sa më efikas dhe për rritjen e produktivitetit në

sektorin bujqësor. Megjithatë, në Bashkinë e Sarandës, drejtori Lama thekson edhe disa problematika të mbartura ndër vite në sektorin bujqësor.

“Kemi një problem madhor që në 20 vite kemi kultivuar të njëjtën bimë në të njëjtën sipërfaqe dhe kjo çon në varfërimin e tokës”, tha ai.

Në këtë kuadër, autoritetet vendore bëjnë me dije se puna nuk do të kufizohet vetëm në ndërhyrjet aktuale, por do të vijojë me mirëmbajtje të vazhdueshme të rrjetit vaditës dhe përmirësim të mëtejshëm të infrastrukturës bujqësore. Qëllimi mbetet krijimi i kushteve sa më të favorshme për fermerët, rritja e rendimentit të prodhimeve dhe forcimi i qëndrueshmërisë së sektorit bujqësor në zonë.



Rama: Linjë kredie me interes minimal 2% për NVM-të

Kryeministri Edi Rama informoi se për ndërmarrjet e vogla e të mesme do të vihet në dispozicion një linjë kredie me një interes minimal 2% dhe interes maksimal 3%.

Në kuadër të programit “Dyfsho sipërmarrjen tënde”, Rama theksoi se kjo linjë kredie do të shoqërohet me një garanci të qeverisë shqiptare për të ulur në mënyrë kuptimplotë riskun e kredisë për bankat.

“Një garanci sovraane që varion nga 30% në 70% sipas nivelit të vlerësuar të riskut”, tha Rama, ndërsa kërkoi që bankat të jenë pak më kurajoze edhe në raport me sektorin e bujqësisë, i cili ka nivel risku më të lartë.

Rama theksoi se projektet e financueshme nga ky sektor duhet të jenë projekte që kanë natyrshëm një risk më të ulët dhe që lidhen me agrobiznesin, agroturizmin, inovacionin dhe me teknologjitë e reja.

“Besoj shumë që edhe një fond granti i cili do të vendoset në dispozicion për të hartuar planet e biznesit, pra për t’i ndi-

neritetit të ri ndërmjet shtetit, sistemit bankar dhe sipërmarrjes shqiptare për programin kombëtar të financimit të



hmuar ndërmarrje dhe vogla të mesme për të bërë aplikimet e tyre, do të vijë si vlerë e shtuar në lehtësimin e marrëdhënies mes subjekteve dhe bankave”, shtoi Rama.

Kreu i qeverisë deklaroi se kjo linjë kredie do të shoqërohet me një garanci të qeverisë shqiptare për të ulur në mënyrë kuptimplotë riskun e kredisë për bankat.

ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme “Dyfsho sipërmarrjen tënde”. Marrëveshja e nënshkruar parashikon 250 milionë euro mbështetje me kredi me norma të ulta interesi dhe 30 milionë euro garanci sovraane për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

250 milionë euro për biznesin, Ibrahimaj: Nxitje investimeve dhe punësimit

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj deklaroi se memorandum i nënshkruar mes qeverisë dhe bankave tregtare synon të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe të rrisë aksesin në financim për biznesin shqiptar.

e një memorandumit të rëndësishëm, i cili lidhet me zhvillimin ekonomik të vendit dhe mbështetjen që duam t’i japim biznesit për t’u zhvilluar”, u shpreh Ibrahimaj.

Ajo nënvizoi se Shqipëria ka regjistruar një rritje të qën-

madh nga procesi i anëtarësimit në BE dhe krijimi i kushteve që biznesi shqiptar të përshtatet me tregun e BE-së me mbi 450 milionë banorë. Kjo është një mundësi e madhe, por shoqërohet edhe me sfida për arrijtjen e standardeve dhe rritjen e eksporteve”, u shpreh ajo.

Duke folur për memorandum, ministrja bëri të ditur se ai parashikon krijimin e një instrumenti financiar për mbështetjen e bizneseve.

“Qëllimi i memorandumit është ndërtimi i një instrumenti kredie, i mbështetur nga Banka e Shqipërisë me një likuiditet prej 250 milionë euro, që do të vihet në dispozicion përmes sektorit bankar për bizneset shqiptare, me norma më të ulëta interesi”, tha Ibrahimaj.

Ajo shtoi se skema do të mbështetet edhe nga Ministria e Financave përmes një garancie sovraane.

“Ky instrument financiar do të mbështetet nga Ministria e Financave me një garanci sovraane, që do t’u mundësojë bizneseve të marrin kredi me mbulim deri në 70% të kolateralit”, u shpreh ajo.

Sipas Ibrahimajt, ky mekanizëm synon të përfshijë sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë bujqësinë dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

“Kjo mbështetje do të nxisë investimet në asete dhe do të ndihmojë bizneset shqiptare të arrijnë standartet e kërkuara për të qenë konkurruese në tregjet ndërkombëtare”, përfundoi ministrja.

Marrëveshja e financimit, 250 milionë euro kredi për NVM-të, garanci sovraane për 70% të kolateralit

U nënshkrua në Tiranë Marrëveshja Kuadër për zbatimin e Programit Kombëtar të Financimit të Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme “Dyfsho Sipërmarrjen Tënde”, midis Bankës së Shqipërisë, ministrive të linjës dhe bankave tregtare.

Marrëveshja u nënshkrua nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Andis Salla, ministri i Financave Petrit Malaj, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë Gent Sejko, ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj dhe Seyhan Pencablil, zëvendëskryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave, drejtor i përgjithshëm dhe anëtar i Bordit Drejtues të BKT.

Në ceremoni ishte i pranishëm edhe Kryeministri Edi Rama.

Marrëveshja ndërmjet shtetit, sistemit bankar dhe sipërmarrjes shqiptare për Programin Kombëtar të Financimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) “Dyfsho Sipërmarrjen

Tënde”, synon të mbështesë bizneset e vogla dhe të mesme në Shqipëri përmes financimeve të favorshme për zgjerimin e investimeve në inovacion, digjitalizim, teknologji

krijimin e një instrumenti të ri kredie me një likuiditet prej 250 milionë euro, i mbështetur nga Banka e Shqipërisë i kanalizuar përmes sektorit bankar për bizneset



dhe investime të gjelbra.

Marrëveshja u vlerësua nga autoritetet si një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të ekonomisë, rritjes së konkurrueshmërisë dhe përfarimit me standartet e Bashkimit Europian.

Marrëveshja parashikon

me norma të ulëta interesi, gjithashtu i mbështetur nga Ministria e Financave përmes një garancie sovraane me vlerën 30 milionë euro, që mbulon deri në 70% të kolateralit, duke lehtësuar aksesin në financim për bizneset dhe fermerët shqiptarë.

Malaj: Kredi të butë për SME-të, 30 milionë euro garanci sovraane për bizneset

Ministri i Financave, Petrit Malaj deklaroi se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME) përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë shqiptare dhe do të

për vlerën e shtuar që ato sjellin”.

Ministri theksoi se, nëpërmjet nismës “Dyfsho sipërmarrjen tënde”, qeveria synon të rrisë aksesin në fi-

do të mbështetet fillimisht me linjën e kredisë të çelur tashmë nga Banka e Shqipërisë në vlerën 250 milionë euro, e cila do të ofrohet me norma të ulëta interesi, ndërsa do të shoqërohet paralelisht edhe me garancinë sovraane prej 30 milionë eurosh që tashmë është çelur, e cila përveç sektorit bujqësor do të zgjerohet edhe për të mbështetur SME-të.

“Garancia sovraane do të rritet, pra nga vlera e 30 milionë që kemi aktualisht do të rritet gradualisht, bazuar në kërkesat që do të na vijnë nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por natyrisht duke mbajtur parasysh edhe mundësitë që ka buxheti i shtetit”, u shpreh Malaj.

Ministri Malaj theksoi se qeveria mbetet e angazhuar që të mbështesë sipërmarrjen dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, për të rritur kapacitetet e tyre teknologjike dhe njerërore, në mënyrë SME-të të rrisin konkurrueshmërinë e tyre dhe të përgatiten për të hyrë në tregun e Bashkimit Europian, ku mundësitë janë të mëdha, por gjithashtu edhe konkurrenca.



jenë në fokus të një pakete të re financimi nga qeveria.

I pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit në Tiranë të partneritetit të ri ndërmjet shtetit, sistemit bankar për Programin Kombëtar të Financimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) “Dyfsho Sipërmarrjen Tënde”, Malaj tha se, “kjo nismë që po ndërmerr qeveria mbështet SME, që përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë shqiptare përsa i përket punësimit, ashtu edhe

nancë për SME-të në sektorë që janë të nënfinancuar, duke i mbështetur në rritjen e kapaciteteve teknologjike, në digjitalizim apo në pjesën e eficiencës së energjisë.

Kjo mbështetje, tha Malaj, synon të sjellë rritje të konkurrueshmërisë së SME-ve dhe rritje të produktivitetit të tyre, që rrjedhimisht do të sjellë përshtetjen e rritjes ekonomike dhe përafrim me të shpejtë me standartet e Bashkimit Europian.

Ministri informoi se nisma

Banka e Shqipërisë licencon zyrtarisht edhe degën e bankës turke Ziraat

Banka e Shqipërisë njoftoi se ka licencuar degën e bankës turke Ziraat për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Shqipëri.

Megjithëse vendimi u shpall, sipas njoftimit zyrtar, ai është marrë në mbledhjen e datës 6 maj 2026, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të miratonte dhënien e licencës për ushtrimin e veprimtarisë bankare

degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë, e ndryshuar.

Në bazë të këtij vendimi, "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" do të ushtrojë veprimtaritë bankare dhe financiare, në përputhje me kushtet dhe kërkesat e licencës së miratuar nga Banka e Shqipërisë.

kushteve teknike dhe organizative për të kryer veprimtari bankare, duke përfshirë sigurimin e ambienteve ku do të ushtrohet veprimtaria, etj.

Ziraat Bank (në turqisht Banka Bujqësore) është bankë me kapital shtetëror dhe 100% e aksioneve zotërohen nga Fondi Turk i Pasurisë, fond publik në pronësi të shtetit të Turqisë. Ziraat e ka origjinën e saj qysh në shekullin e 19-të, në epokën e Perandorisë Osmane.

Ajo u themelua në vitin 1863, fillimisht si një fond kooperativ për financimin e bujqësisë, ndërsa në vitin 1888 u shndërrua zyrtarisht në bankë, me emrin që mban edhe sot, Ziraat.

Ziraat Bank është banka më e madhe në Turqi, ku mban afërsisht 18% të tregut, me asete totale për një vlerë prej rreth 189 miliardë USD, në fund të vitit 2025. Në bilancin e konsoliduar, në nivel grupi (duke përfshirë edhe bankat dhe kompanitë e tjera të zotëruara prej saj brenda dhe jashtë Turqisë), Ziraat raporton asete totale për afërsisht 207 miliardë USD. Përveç bankave dhe kompanive financiare në Turqi, Ziraat zotëron banka të kontrolluara prej saj në Gjermani, Rusi, Kazakistan, Uzbekistan, Gjeorgji, Azerbajxhan, Bosnje Hercegovinë, Mal të Zi dhe Kosovë.

Banka turke është e pranishme me degët e saj (që nuk veprojnë si banka të ndara) dhe në Angli, Irak, Greqi, Bullgari, Arabinë Saudite, Qipron Turke, Bahrein, ndërsa ka zyra përfaqëse edhe në Emiratet e Bashkuar Arabe dhe në Egjipt.

Dega e bankës Ziraat është banka e dytë e licencuar këtë vit nga Banka e Shqipërisë, pas Bankës Jet, në muajin mars të këtij viti.

"Monitor"



dhe financiare degës së bankës së huaj "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania".

Miratimi paraprak për licencim ishte dhënë në gusht të vitit të kaluar, me vendimin 38/2025 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Sipas njoftimit zyrtar, në përputhje me dokumentacionin e paraqitur në Bankën e Shqipërisë, është shqyrtuar aplikimi i "Degës së Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania" për pajisjen me licencë për ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare në mbështetje të kërkesave të ligjit 9662/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të rregullores së Këshillit Mbikëqyrës 14/2009 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe

Sipas ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", licencimi i bankës dhe i degës së bankës së huaj kalon në dy faza: miratimi paraprak i licencës dhe dhënia e licencës.

Ligji parashikon se, dega e bankës së huaj që ka marrë miratimin paraprak për licencë, brenda 12 muajve duhet të plotësojë të gjitha kushtet e parashikuara në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në mënyrë që të pajiset me licencën për fillimin e veprimtarisë bankare në vendin tonë.

Gjatë kësaj periudhe, subjekti që ka marrë miratimin paraprak duhet të plotësojë kushtet kryesore për të mundësuar nisjen e aktivitetit të saj, duke filluar nga derdhja e kapitalit të kërkuar, punësimi i stafit të nevojshëm, krijimi i

Kajsia e Xibrakës – Prodhim i bollshëm pas 5 vitesh, fermerët kërkojnë mbështetje

Pas pesë vitesh pritjeje dhe pune të vazhdueshme, fermerët e zonës së Xibrakës në Lushnje po marrin këtë vit prodhimin e parë të bollshëm nga plantacionet me kajsji.

"Këto janë viti i pestë edhe sivjet janë tamam në prodhim. Nëse i shërben bukur, vijnë gjëra të bukura. Klima ka qenë e përshtatshme për sivjet."

Këtë sezon, edhe çmimi ka qenë i favorshëm për fermerët. "Fillimisht ishte më i lartë, pastaj duke ardhur ka zbritur. Sot është 3 00 lekë."

Fermerët tregojnë se gjithçka është arritur falë punës së përditshme, ndërsa kërkojnë më shumë mbështetje përmes subvencioneve për zhvillimin e bujqësisë në zonat kodrinore të Xibrakës.

Sipas tyre, mungesa e

rugëve të parcelave, problemet me sistemin vaditës dhe copëzimi i sipërfaqeve bujqësore po pengojnë zhvillimin dhe zgjerimin e fermave në zonë.

"Jo, nuk kam aplikuar, por normalisht që ndihma do të ishte mirë. Tani zor është për vaditje. Na duhen shumë gjëra,

jo mjete bujqësore."

"Ne te ara nuk kemi rrugë. Rrugët janë, por nuk shkojnë dot me mjet. Duhet të shkosh në këmbë, nafta tani nuk e japin."

Pavarësisht vështirësive, prodhimet bujqësore të Xibrakës vazhdojnë të gjejnë treg, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.



Vaksinimi i bagëtive të imëta, veterinerët apelojnë për respektimin e protokolleve

Në këtë periudhë, specialistët veterinarë po u bëjnë thirrje,

me qëllim mbrojtjen e tyre nga sëmundjet dhe parazitozat.



rje blegtorëve që të tregojnë kujdes të veçantë për vaksinimin dhe dehelmintizimin e bagëtive të imta, si dele dhe

Sipas Përgjegjësit të punës racore në QTTB, gjatë sezonit të kullotave rritet rreziku i përhapjes së sëmundjeve in-

fektive dhe parazitare, ndaj zbatimi i protokolleve veterinarë mbetet i domosdoshëm për ruajtjen e shëndetit të tufave dhe garantimin e prodhimit blegtoral.

"Kjo periudhë në bagëtitë e imëta duhet të kryen disa lloje vaksinimesh sipas një protokollit të përcaktuar veterinar sepse në bagëtitë e imëta është shumë i rëndësishëm parandalimi sesa kurimi", theksoi Lazzart Suraj, Përgjegjës i sektorit të punës racore, QTTB Korçë.

Suraj thekson se një tufë e vaksinuar dhe e kontrolluar rregullisht ka më pak probleme shëndetësore, prodhim më të mirë qumështi dhe rritje më të sigurt të qengjave dhe kecape.

Investime në pemët arnore, në Maliq po shtohen investimet në kultivimin e kësaj kulture me kërkesë të lartë në treg

Fermeri i ri Roxhens Zgorani nga fshati Poceshtë i bashkisë Maliq po investon në kultivimin e pemëve arnore, duke e konsideruar këtë sektor si një nga më fitimprurësit në bujqësi.

Në fermën e tij ai ka mbjellë arra, lajthi dhe bajame, kultura për të cilat thotë se kanë kërkesë të lartë në treg dhe sjellin të ardhura të kënaqshme për fermerët.

Sipas Roxhensit, zgjedhja për t'u përqendruar tek pemët arnore ka ardhur pas studimit të kushteve klimatike dhe potencialit që ka zona për këto kultura.

"Pemët e parë e kam mbjellë që në klasë të 6 apo të 7 dhe pastaj ka qenë pasion i vazhdueshëm. Arrorët janë ndër kulturat që realisht ja vlen të kultivohen dhe nuk duan shumë shërbim për sa i

përket mbrojtjes nga sëmundjet e ndryshme", u shpreh fermeri.

për shkak edhe pse janë përshtatur me klimën e rajonit tonë por dhe për cilësinë e pro-



Ai shprehet se ka preferuar pemë autoktone, pasi përshtaten më mirë me klimën dhe tokën e zonës, duke kërkuar më pak ndërhyrje dhe duke garantuar prodhim më të qëndrueshëm.

"I kam varietete autoktone

dhimit sepse janë më shumë cilësore në aspektin e vlerave ushqyese", tha ai.

Fermeri i ri thotë se puna në bujqësi kërkon përkushtim dhe durim, por rezultatet janë pozitive kur investimi bëhet në kulturat e duhura.

Mjeshtrit që ruajnë traditën e Gjirokastrës, Theodhori Gjini prej 40 vitesh mban gjallë zanatin e ndërtimit me gurë

Në Gjirokastër, aty ku gurët flasin gjuhën e traditës dhe ku puna e mjeshtrit merr një vlerë të veçantë, ende jetojnë njerëz që ruajnë zanatet e trashëguara brez pas brezi. Njëri prej tyre është Theodhori Gjini, mjeshtrë i ndërtimit me gurë, i cili prej më shumë se katër dekadash

vazhdon t'i japë jetë gurit dhe artit të ndërtimit tradicional.

"Në 74-ën kur isha nxënës siç fillova punë vajta pas ustallarëve të vjetër atje pastaj me ato mundësitë e mia nga fshati kam punuar me mjeshtrë me ustallarë dropullitë mjeshtrit që e njihnin mirë zanatin", tha ai.

Për Theodhoriun, puna më e bukur mbetet ndërtimi i çatave të gurta, simbol i arkitekturës karakteristike të qytetit të gurtë.

"Kam pasur në fshat nja dy mjeshtrë që më kanë marrë nxënësi nga pas. U hapja dërrasën në çati, i shikoja edhe ua bleva zanati. Me dërrasën e kam si gjë më të lehtë, kurse me mur vajta tërë jetën që s'më është ndarë guri", u shpreh ai.

Me durim dhe përkushtim, Theodhori Gjini vazhdon të ruajë teknikat e vjetra të ndërtimit, të cilat sot po bëhen gjithnjë e më të rralla, duke mbajtur gjallë një traditë që përbën pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës





SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FED
invest 

**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

INTERVISTË

(Vijon nga faqja 3)

Integrimi - BE Transformim ose faliment!

Nga retorika politike, çështja e integrimit europian ka nisur të hyjë në fazën e vlerësimeve për përmbushjen e kushteve të sigurisë. Të parët që duhet të kalojnë testimin janë 904 operatorë të produkteve ushqimore.

Me një listë detyrash në dorë, trupa e inspektorëve të Autoritetit Kombëtar Ushqimor (AKU) po troket derë më derë te çdo biznes për dhënien e vlerësimeve në përmbushje të standardeve që kërkon Bashkimi Europian (BE).

Teksa për bizneset nisi përballja me zgjidhjen e ushtrimit ekonomik më të vështirë të këtyre 30 viteve tranzicion. Pas vlerësimit të bërë nga AKU bizneset po klasifikohen në 4 kategorizime (nga Klasa I deri te Klasa IV). Procesi i vlerësimit do të përfundojë më 31 korrik 2026.

Në sektorin e përpunimit të qumështit, ndër të parët që po vlerësohen, frika e përpunuesve është përsëritja e modelit bullgar. Gjatë procesit të anëtarësimit të Bullgarisë në BE, në vitet 2005-2009, rreth 60 deri në 70% e bizneseve të vogla të përpunimit të qumështit u mbyllën. Dalja e tyre nga tregu erdhi pasi nuk arritën të përshtaten me standardet e BE-së në fushat e sigurisë ushqimore, rinovimin e teknologjisë dhe për mjedisin.

Taulant Pupa, drejtues i kompanisë së përpunimit të qumështit "Vita 2001" mendon se modeli bullgar është referenca kryesore, për mënyrën se si do të ndërtohet procesi i integrimit në sektorin e qumështit në Shqipëri.

Ai pohon se problemi më i madh nuk është mungesa e standardeve të teknologjia e prodhimit apo gjurmueshmëria e mallrave të bulmetit, por te trajtimi i mbetjeve dhe i ujërave të ndotura brenda fabrikave dhe baxhove.

"Kompania jonë, prej vitesh, - për investimet e kryera që kanë mundësuar përmbushjen e standardeve për prodhimin e produkteve të bulmetit sipas kërkesave të BE-së -, ka pasur si referencë modelin bullgar. Gjatë procesit të integrimit në këtë shtet pati mbyllje masive të kompanive të përpunimit të qumështit, veçanërisht dhe të baxhove të vogla. Dhe një nga kërkesat më të forta të BE-së në atë kohë ishte përmbushja e kriterëve mjedisorë, për trajtimin e ujërave të ndotura dhe të mbetjeve për të shmangur kontaminimin e kryqëzuar në prodhim. Është e realizueshme, por nëse investohet me teknologjinë e duhur dhe përballohet kostoja. Pikërisht ky do të jetë shkaku kryesor që mund të sjellë falimentimin e shumë bizneseve në vend, përfshirë edhe struktura të konsoliduara në teknologji dhe gjurmueshmëri që nuk plotësojnë kushtin për trajtimin e mbetjeve".

Z.Pupa llogariti se kostoja për plotësimin e standardit mjedisor është e lartë, veçanërisht për baxhot dhe fabrikat e vogla, që do t'u kërkohej si investim i menjëhershëm dhe jo i zbatuar gradualisht ndër vite.

"Kostoja për vendosjen e një impianti që përpunon mbetjet e industrisë së qumështit në një baxho kushton rreth 80 mijë euro, ndërsa për një fabrikë të madhe, deri në 600 mijë euro. Për shumë biznese të vogla, këto investime janë praktikisht të papërballueshme. Një baxho nuk arrin t'i përballojë këto kosto. Mendoj se këtu duhet të ndërhyjë shteti për investimet dhe të ndihmojë baxhot që punësojnë njerëz, që të mos mbyllën".

AKU, vlerësime për sigurinë ushqimore, bizneset po kategorizohen në 4 Klasa

Për rreth 4 muaj, trupa e inspektorëve të Autoritetit Kombëtar Ushqimor (AKU) do të vlerësojë 904 operatorë ushqimorë për përmbushje të standardeve të sigurisë ushqimore sipas kërkesës së Bashkimit Europian.

Drejtoresha e Autoritetit Kombëtar Ushqimor, Blerina Gjylameti, në intervistën për "Monitor" shpjegon se vlerësimi ka nisur më 14 prill dhe deri tani ka përfunduar për 225 biznese.

"Procedura e vlerësimit dhe kategorizimit ka nisur më datë 14 prill dhe do të vazhdojë deri në datë 31 korrik 2026. Qëllimi i procesit të kategorizimit është identifikimi i stabilimenteve që janë në përputhje me kërkesat ligjore: (Kategoria 1) - Stabilimentet që rezultojnë në përputhje të plotë me standardet e BE-së. (Kategoritë 2, 3 dhe 4) - Klasifikimi në nënkategori do të shërbejë për të përcaktuar nivelin dhe shkallën e mospërputhshmërisë. Nga ana tjetër, duhen llogaritur burimet dhe afati i nevojshëm për menaxhimin dhe korrigjimin e problematikave të konstatuara, si dhe procedurat që duhen ndjekur për zbatimin dhe monitorimin e procesit të përmirësimit.

Respektimi i kërkesave të sigurisë ushqimore, sipas legjislacionit në fuqi, është i detyrueshëm pavarësisht rezultatit të kategorizimit dhe në rastet kur konstatohet se një ushqim

paraqet rrezik për shëndetin e konsumatorit, do të ndërmerren masa të menjëhershme, nga trupat vlerësuese. Në mënyrë të menjëhershme do të nisë procedura e inspektimit me qëllim ndalimin e hedhjes së produkteve të dëmshme në treg.

Kategoria 1: klasifikohen stabilimentet që ushtrojnë aktivitet në përputhje të plotë me kërkesat e BE-së. Kategoria 2: klasifikohen stabilimente ku vihen re mospërputhshmëri të vogla që mund të zgjidhen gjatë një periudhe të shkurtër kohore (3-6 muaj). Kategoria 3: klasifikohen stabilimente ku vihen re mospërputhshmëri të konsiderueshme (lidhur me planimetrinë, infrastrukturën e ndërtimit, të cilat kërkojnë punime ose rinovime të mëtejshme dhe burime financiare të konsiderueshme ose stabilimentet që janë dekategoriuar nga kategoria 2) që mund të përmirësohen për një periudhë kohore më të gjatë se ajo e kategorisë 2.

Për këto stabilimente do të përgatiten plane veprimi për korrigjimin e mospërputhjeve në një fazë të mëvonshme. Kategoria 4: klasifikohen stabilimente ku vihen re mospërputhshmëri madhore dhe stabilimenti: përbën rrezik të konsiderueshëm për shëndetin; nuk duhet të hedhë produkte në treg; duhet të mbyllet sepse nuk është në përputhje me legjislacionin kombëtar; nuk mund të arrijë standardet e BE-së. Per kategorinë 4, AKU merr masa për mbylljen e stabilimentit".

Znj. Gjylameti theksoi se krahas vlerësimit, inspektorët po japin edhe udhëzime të detajuara për përmirësimin e situatës,



për rastet kur disa prej standardeve rezultojnë të paplotësuar. Afati maksimal i përmirësimeve është deri në një vit. Në përfundim të procesit, ku edhe AKU do ta ketë më të qartë situatën për sigurinë ushqimore, pritet të hartohet Strategjia Kombëtare, ku sipas zonjës Gjylameti do të jetë për zgjidhjen e problemeve.

"Vlerësimi dhe kategorizimi realizohen nëpërmjet përdorimit të listave të verifikimit, të personalizuar sipas veprimtarive specifike për stabilimentet ushqimore. Listë-verifikimi do të plotësohet me komente në çdo rubrikë, pavarësisht nëse janë identifikuar mospërputhshmëri ose jo. Duke orientuar kështu OBU-të, mbi masat që duhet të marrin për përmirësimin e stabilimenteve.

Pasi të kemi rezultatet e plota, në një fazë të mëvonshme, për stabilimentet e kategorisë 3 do të përgatiten plane veprimi për korrigjimin e mospërputhshmërive. AKU mbështetet në ekspertizën teknike të GIZ dhe projektit EUforFoodSafety, të cilët po asistojnë harmonizimin e procedurave, rritjen e standardeve, kapaciteteve dhe informimin", theksoi zonja Gjylameti.

Nisur nga përvoja e vlerësimit të kompanisë "Lufra", Luis Ndreka shpjegon në mënyrë të detajuar për "Monitor" se si AKU po vepron me vlerësimet për përmbushjen e standardeve të BE-së. "Sistemi i kontrollit që po zhvillon AKU është mjaft rigoroz. Inspektorët janë të pajisur me një 'check list'. Pas vlerësimeve, bizneset kategorizohen në katër klasa. Te "Klasa I" kategorizohen kompanitë që mund të shesin menjëherë në Bashkimin Europian. Në Shqipëri, përjashtuar sektorin e prodhimeve të produkteve me origjinë shtazore, te 'Klasa I' po kategorizohen eksportuesit. Deri tani, për shkak të mungesës së përafritit të legjislacionit, kompanitë vendase të produkteve me origjinë shtazore nuk eksportojnë në shtetet e Bashkimit Europian. Por kjo nuk do të thotë që ofrojnë produkte ushqimore jo të sigurta, pasi ata eksportojnë në shumë shtete të tjera, përfshirë edhe SHBA.

Te 'Klasa II' po kategorizohen kompanitë që hasin probleme të vogla, por të cilat janë të zgjidhshme brenda afatit 3-mujor. Te 'Klasa III' po klasifikohen kompanitë që duhet të plotësojnë standardet nëpërmjet investimeve që zgjasin më shumë se 3 muaj. Te 'Klasa IV' janë kategorizuar bizneset që nuk përmbushin standardet e sigurisë jo vetëm për tregun e BE-së, por as për tregun e brendshëm. Kjo ka sjellë mbylljen

e menjëhershme të tyre nga AKU".

Procesi i kontrollit nuk do të kufizohet vetëm nga institucionet shqiptare. Pas fazës së parë, në vend do të vijë edhe trupat inspektuese nga BE, për verifikime me bazë rrisht.

"Vlerësimet po kryhen nga trupa rajonale e inspektorëve. Në vijim do të inspektohen edhe nga trupa qendrore. P.sh. nëse një kompani është kategorizuar te 'Klasa II' dhe trupa qendrore e klasifikon te 'Klasa III', vlerësimi do të nisë nga e para për të gjithë grupin e bizneseve që kjo trupë rajonale ka vlerësuar. Të njëjtën procedurë do të ndjekin edhe trupat inspektuese të BE-së. Në bazë rrisht, do të kontrollojë në terren vlerësimet e AKU-së", thotë ai.

Për pjesën dërmuese të kompanive të sektorit, zoti Ndreka thotë se faza e parë po konsiderohet si ushtrim për vlerësim të situatës që iu shërben jo vetëm drejtuesve të bizneseve, por edhe për vetë institucionet shtetërore. Evidentimi i qartë i situatës, sipas tij, do të shërbejë edhe për përfitime të fondëve ndihmë që mund të jepen nga BE në mbështetje të sektorëve prodhues.

Nga ana tjetër, sipas të dhënave paraprake të Shoqatës së Industrisë së Përpunuesve të Qumështit, 10 deri në 15% e subjekteve të sektorit të përpunimit të qumështit janë klasifikuar te "Klasa IV", çka nënkupton se nuk përmbushin as standardet e sigurisë për të tregtuar në vend. Për rrjedhojë këto biznese, kryesisht baxho të vogla, janë mbyllur nga AKU.

Vetëm 10-15% e bizneseve konsiderohen të përgatitura

Teksa Shqipëria ka hyrë drejt fazës konkrete të vlerësimit, Shoqata Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë (BPSH) dhe Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) ngrenë alarmin për nivelin e ulët të bizneseve shqiptare që kanë deklaruar se janë të përgatitura me standardet e BE-së.

Sekretari i përgjithshëm i BPSH-së, zoti Arben Shkodra, shpjegon se që të mbijetojnë, për të gjithë operatorët do të jetë i detyrueshëm transformimi për përshtatjen e standardeve, përfshirë ato për sigurinë ushqimore, teknologjisë së prodhimit, sistemin e gjurmueshmërisë që zbatojnë, mbrojtjen e mjedisit, certifikimet e punësimit etj.

Por në këtë fazë, sipas tij, shumica e bizneseve nuk kanë as informacionin dhe as kapacitetet financiare për të realizuar transformimin që kërkon integrimi në BE.

"Bazuar në një analizë paraprake të bërë nga Ministria e Ekonomisë, sipas vetëdeklarimeve të bizneseve, rezultojnë se rreth 10 deri në 15% e tyre janë relativisht të përgatitur për të qenë pjesë e Bashkimit Europian. Rezultojnë një kategori tjetër ku përfshihen kompanitë që kanë probleme, por të zgjidhshme. Dhe është një tjetër kategori, ku përfshihet numri më i madh i bizneseve që nuk përmbushin asnjë standard teknik për të qenë pjesë e tregut europian, por që edhe nuk kanë dijeni sesi do t'i plotësojnë".

Z. Shkodra thotë se nga procesi i parë i certifikimit, sektori më i goditur do të jetë përpunimi industrial ushqimor.

"Nga një analizë e Ministrisë së Ekonomisë, por edhe nga vlerësimet e kryera prej kohësh në terren nga shoqatat e biznesit, gjykojmë se sektori që do të goditet më shumë nga procesi i parë i vlerësimit dhe certifikimit të standardeve të BE-së, do të jenë degët e nënsektorit të përpunimit industrial ushqimor. Përfshirë sektorët, si: pijet alkoolike dhe joalkoolike, produktet ushqimore që prodhohen, tregtohen dhe përpunohen nga frutat, perimet, vaji i ullirit, brumërat, mishi dhe nënproduktet e tij, peshku etj.

Aktualisht, vëmendja kryesore e BE-së është identifikimi dhe vlerësimi i të gjithë sektorëve dhe nënsektorëve të industrisë ushqimore, me qëllim që ato të integrohen brenda standardeve ekonomike dhe të garantohet siguria ushqimore për konsumatorin europian.

Ne vlerësojmë që edhe nënsektorë të përpunimit industrial joushqimor do të kenë mjaft probleme. Sektori i ndërtimit do të kalojë në një filtër shumë të dendur të BE-së, pasi duhet të garantohet që jo vetëm materialet që përdoren të jenë të bazuara mbi eurokodet, por edhe procesi i ndërtimit në kantiere të zhvillohet mbi rregulla shumë strikte.

Për rrjedhojë, të gjitha kompanitë shqiptare duhet të nisin punën për plotësimin e standardeve.

Dy janë fjalitë kryesore në integrim: arritja e konkurrueshmërisë dhe transformimi. Pa transformim nuk mund të arrihet konkurrueshmëria".

(Vijon në faqen 11)

INTERVISTË

(Vijon nga faqja 10)

Integrimi - BE Transformim ose faliment!

Fatura e kostos

Pikëpyetjet e para në lidhje me përballimin ose jo të kostove dalin nga analizat e shoqatave të bizneseve.

Për Shoqatën e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë, sipas Arben Shkodrës, problemi më i madh vjen nga mënyra si është ndërtuar struktura e ekonomisë shqiptare, e dominuar nga bizneset e vogla që automatikisht rrisin shkallën e pamundësisë financiare për përballimin e kostove.

“Duke parë strukturën e ndërmarrjeve në vend, ku 99% e kompanive janë mikrondërmarrje, 1 deri në 2% janë kompani të vogla dhe të mesme, 98% e biznesit nuk kanë mundësi reale monetare dhe kapacitete për të bërë transformimin, me qëllim arrijtjen e konkurrueshmërisë dhe mbijetesën në treg”, deklaroi ai.

Në zonën e Juglindjes, nga vlerësimet e AKU, deri tani janë mbyllur 3 baxho. Sipas burimeve nga tregu, baxhot e mbyllura vepronin në kushte primitive.

Taulant Pupa, i cili drejton fabrikën e përpunimit të qumështit “Vita 2001” e pranishme në treg prej dy dekadash, nisur nga analiza financiare për kompaninë e tij vlerëson se kostoja për përbushjen e standardeve është e lartë. Pavarësisht koston, z. Pupa thekson se mbetet i angazhuar për investime në plotësimin e standardeve të kërkuara, pasi do të vijojë të qëndrojë në treg. Por ai vlerëson se si kostot edhe afati i lejuar për përbushjen e kushteve (maksimali është deri në 1 vit) nuk mund të përballohen nga bizneset e vogla.

“Kostot dhe afati i lejuar për investime shtesë do të jenë të përbalueshme vetëm prej kompanive që në mënyrë të vazhdueshme prej vitit 2000 e deri më sot kanë investuar për konsolidim. Në të kundërt, një fabrikë apo një baxho që do të kërkojë të hyjë sërish në treg e ka të pamundur të përbushë standardet. Do t'i duhen të paktën 3 deri në 4 vite”.

Drejtuës të shoqatave të bizneseve prodhuese, por edhe vetë sipërmarrësit, ende janë të paqartë nëse do të ndihmohen nga shteti dhe BE për përballimin e kostove të investimeve.

Edhe presidenti i Shoqatës së Eksportuesve Shqiptarë, Alban Zusi, është i paqartë për ndarjen e përballimit të kostove. Shqetësim për të është edhe afati i shkurtër 12-mujor i lënë për të përbushur standardet e sigurisë ushqimore, që po krijojnë presion të madh te bizneset e sektorit të agroushqimit, pasi edhe subjektet që prodhojnë produkte të sigurta do të duhet të kryejnë investime të kushtueshme për plotësimin e standardeve të reja.

“Kërkesat për përbushjen brenda një periudhe 12-mujore të standardeve të Bashkimit Europian për sigurinë ushqimore po vendosin presion të madh mbi bizneset. Edhe subjektet që prodhojnë produkte të sigurta do të përballen me detyrimin për të plotësuar standarde që kërkojnë investime të konsiderueshme dhe kosto operative shtesë pas investimit.

Deri tani është lënë të kuptohet që këto investime duhet të mbulojnë nga vetë bizneset. Në kushtet kur sipërmarrjet po humbasin çdo ditë terren në konkurrueshmëri, ato detyrohen që energjitë dhe fondet e mbetura t'i përdorin për investime që lidhen me përbushjen e standardeve dhe jo drejtpërdrejt me rritjen e konkurrueshmërisë apo mbijetesën në treg.

Z. Zusi ngriti shqetësimin edhe për konkurrencën nga bizneset informale në tregun vendas, duke theksuar se bizneset e rregullta dhe me standarde po përballen me kosto shtesë, ndërsa informaliteti vazhdon të jetë problem. Ai paralajmëroi se shumë biznese po rivlerësojnë të ardhmen e aktivitetit të tyre për shkak të presionit në rritje dhe pasigurive në treg.

“Edhe investimet që do të realizohen brenda 12 muajve nuk garantojnë automatikisht hyrjen në tregjet europiane. Ndërkohë, në tregun vendas bizneset e rregullta dhe me standarde po përballen me konkurrencën e subjekteve informale.

Në këto kushte, rritja e kërkesave për standarde po shton presionin mbi sipërmarrjet, duke bërë që shumë prej tyre të rivlerësojnë të ardhmen e aktivitetit dhe mënyrën se si do të vazhdojnë operimin në treg apo do të kërkojnë të dalin nga tregu”.

Rreziku i kreditimit për investime

Agim Rrapaj, nga KASH, thotë se investimet do të përballohen nga bizneset përmes kreditimit të disa prej programeve të shpallura nga qeveria.

Informacioni për standardet e detyrueshme të BE-së për bizneset bujqësore shqiptare ka filluar të jepet, por ka mungesë ndërgjegjësimit për veprim të menjëhershëm për të vendosur e për të vepruar pa humbur kohë për përmirësimin e teknologjisë. Fondet që do të përdoren për këtë proces mund të gjenden përmes disa burimeve si p.sh.: kredia me kushte

lehtësuese prej 250 milionë eurosh, me interes 2%, shoqëruar me Garancinë Sovrane prej 30 milionë eurosh, që ka akorduar qeveria shqiptare për ato subjekte që nuk plotësojnë kolateralin e kërkuar nga bankat e nivelit të dytë; Grant për skemën kombëtare të mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural prej 52 milionë eurosh; Granti i programit IPARD III prej 146 milionë eurosh; Kredi nga Banka Shqiptare e Zhvillimit dhe nga bankat e nivelit të dytë; Fonde nga aktiviteti financiar i vetë subjekteve; Fonde nga disa projekte pilot të financuara nga donatorët si GIZ, BB, BERZH, BEI etj.”.

Edhe Luis Ndreka thotë se bizneset që do të kërkojnë të mbijetojnë do të duhet të marrin rrezikun e kreditimit të investimeve.

“Në opinionin tim, dy janë rrugët për bizneset: ose duhet të vendosin të plotësojnë standardet e kërkuara dhe të investojnë, duke marrë rrezikun e kreditimit ose duhet të vendosin që nuk do ta bëjnë këtë gjë. Mendoj se shumica e bizneseve të sektorit kanë përvojën e duhur dhe do të synojnë të ecin përpara”.

Sfidat e sektorit të bujqësisë

Drejtuësi i KASH, Agim Rrapaj, thekson se procesi i integritimit nuk mund të shihet i shkëputur nga zinxhiri i plotë i prodhimit ushqimor, duke nisur nga fermeri deri te konsumatori final.

Sipas tij, sfida nuk qëndron vetëm te fabrikat apo baxhot, por tek e gjithë struktura e prodhimit bujqësor në vend.

“Në vend janë 354 mijë prodhues të produkteve bujqësore dhe blegtorale, që kanë tokë për të prodhuar. Nga ky total, sot kanë të drejtë të tregtojnë prodhimet e tyre sipas kriterëve që ka vendi, rreth 110 mijë. Pra janë subjekte të pajisur me NIPT, përfshirë bujq, fermerë, peshkatarë, bujtina dhe agropërpunues që prodhojnë për tregun.

Të gjithë këto biznese duhet të grupohen në njësi shërbimi dhe të organizohen si organizata prodhimi, të bashkëpunojnë në modele si ato të Zvicrës, Japonisë, Izraelit, Italisë etj., në mënyrë që të arrijnë të plotësojnë kriteret për certifikim të standardeve sipas BE-së.

Nga vlerësimet e para, realizuar përmes verifikimeve në terren në biznese, si: thertore, te përpunuesit e qumështit (fabrika dhe baxho), bujtina, si dhe në sektorin e agropërpunimit (konservimi i perimeve të grira, konservat, ushqimet me origjinë blegtorale) janë dhënë rekomandime, kryesisht për përmirësimin e standardeve për asgjësimin e mbetjeve në thertore.

Rekomandimet te bujtinat janë fokusuar te përmirësimi i sistemeve të mbrojtjes nga zjarri. Shumë prej tyre kanë rezultuar me dritare të vogla, që rrisin rrezikun për jetën në rast rënie zjarri.

Po ashtu janë edhe rreth 300–400 subjekte eksportuese, përfshirë qendrat e grumbullimit dhe eksportit që plotësojnë kushtet e sigurisë ushqimore sipas standardeve të BE-së. Edhe ky grup mund të ketë probleme që kanë nevojë të përmirësohen, por e përballojnë koston e investimeve për përbushjen e këtyre standardeve”.

Drejtuësi i KASH thotë se përbushja e standardeve është detyrim për të gjitha bizneset që do të kërkojnë të qëndrojnë në treg. Z. Rrapaj shton se bizneset duhet të nisin nga puna për përbushjen e tyre, për të mos rrezikuar daljen nga tregu.

Afatet dhe pasojat për bizneset

Shoqata e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë thotë se periudha reale që bizneset kanë në dispozicion për t'u përshtatur me standardet e BE-së është edhe rreth 3 vite kohë. Pas anëtarësimit, këto standarde do të jenë detyrim ligjor. Në rast të mospërbushjes së kërkesave, bizneset nuk do të lejohen të tregtojnë as në tregun shqiptar dhe as në atë europian, duke rrezikuar mbyllje ose falimentim.

“Bizneset kanë edhe rreth tre vite kohë dhe ekonomia shqiptare ka mundësi të shpëtojë një pjesë të konsiderueshme të tyre, duke i bërë të denja për tregun europian. Në të kundërt, kompanitë që nuk përbushin standardet do të dalin nga tregu.

Tregu nuk do të mbetet bosh, ai do të zëvendësohet nga kompani të tjera europiane, duke sjellë edhe një konkurrencë të fortë në tregun vendas, por edhe ‘pushtimin’ e ri ekonomik të vendit”, theksoi Arben Shkodra.

Si përfundim, shoqatat e bizneseve paralajmërojnë se integrimi europian nuk është thjesht një objektiv politik, por një realitet i ri ekonomik, ku do të mbijetojnë vetëm ato biznese që do të arrijnë të përshtaten me standardet e reja të tregut dhe do të përballojnë kostot e transformimit.

INTERVISTAT

Siguria ushqimore, AKU pararojë për standardin europian**Flet drejtoresha e AKU, Blerina Gjylameti**

Procesi i kategorizimit të operatorëve ushqimorë konsiderohet një nga hapat më të rëndësishëm në rrugën e Shqipërisë drejt standardeve europiane të sigurisë ushqimore.

Për rreth 4 muaj, trupa e inspektorëve të Autoritetit Kombëtar Ushqimor (AKU) do të vlerësojë 904 operatorë ushqimorë për përbushje të standardeve të sigurisë ushqimore sipas kërkesës së Bashkimit Europian. Vlerësimi ka nisur më 14 Prill dhe deri tani ka përfunduar për 225 biznese.

Drejtoresha e Autoritetit Kombëtar Ushqimor, Blerina Gjylameti, në intervistën për “Monitor” shpjegon sfidat, problematikat dhe masat që po ndërmerren për të garantuar përbushjen e kërkesave të Bashkimit Europian.



Cilat janë kërkesat kryesore që vendi ynë duhet të përbushë sipas Kapitullit 12 për çështjet e sigurisë ushqimore?

Është hera e parë, kur sektori më i vështirë dhe i panegociueshëm nga BE: Siguria Ushqimore; i nënshtrohet procesit të kategorizimit. Ndaj jemi në pararojë, ku nga ne pritët jo vetëm skanimi i situatës aktuale, ku jemi, por dhe planifikimi dhe

përmirësimi i kriterëve dhe standardeve sipas kërkesave më të mira europiane. Ky proces kërkon bashkëpunim të ngushtë me qeverinë, politikëbërjen, institucionet, universitetet dhe shoqërinë civile. Synohet arritja e tregut të BE, por mbi të gjitha, garantimi i sigurisë për konsumatorin.

Kapitulli 12 i Acquis të BE-së ndërthur Sigurinë Ushqimore, politikën veterinarë dhe fitosanitare dhe është një nga kapitujt më kompleksë në procesin e integritimit në BE. Me qëllim përbushjen e këtyre objektivave, kërkohet përafrimi i legjislationit, si dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe atyre laboratorike, për mbulimin e plotë të zinxhirit nga ferma në tavolinë.

Kur ka nisur ky proces dhe kur është afati i përfundimit? Deri më tani në çfarë faze ndodhet, sa është në total numri i stabilimenteve me origjinë shtatzore që do të kategorizohet, sa është numri i atyre që janë kategorizuar?

Procedura e vlerësimit dhe kategorizimit ka nisur më datë 14 prill dhe do të vazhdojë deri në datë 31 korrik 2026.

Qëllimi i procesit të kategorizimit është identifikimi i stabilimenteve që janë në përputhje me kërkesat ligjore:

(Kategoria 1) - Stabilimentet që rezultojnë në përputhje të plotë me standardet e BE-së.

(Kategoritë 2, 3 dhe 4) - Klasifikimi në nënkategori do të shërbejë për të përcaktuar nivelin dhe shkallën e mospërbushshmërisë. Nga ana tjetër, duhen llogarit burimet dhe afati i nevojshëm për menaxhimin dhe korrigjimin e problematikave të konstatuara, si dhe procedurat që duhen ndjekur për zbatimin dhe monitorimin e procesit të përmirësimit.

Respektimi i kërkesave të sigurisë ushqimore, sipas legjislationit në fuqi, është i detyrueshëm, pavarësisht rezultatit të kategorizimit dhe në rastet kur konstatohet se një ushqim paraqet rrezik për shëndetin e konsumatorit, do të ndërmerren masa të menjëhershme, nga trupat vlerësuese. Në mënyrë të menjëhershme do të nisë procedura e inspektimit me qëllim ndalimin e hedhjes së produkteve të dëmshme në treg.

Është planifikuar vlerësimi i 904 operatorëve të biznesit ushqimor, nga të cilët deri më tani janë vlerësuar 225 OBU.

Në deklaratat zyrtare përmendet shpesh për përafrim të standardeve me ato të BE-së. A janë të informuara realisht bizneset për këto kërkesa dhe cilat janë problemet më të shpeshta që po hasni në terren te bizneset gjatë këtij procesi?

MBZHR është në proces përafrimi të legjislationit me BE.

INTERVISTË

(Vijon nga faqja 11)

Integrimi - BE Transformim ose faliment!

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për çdo dispozitë ligjore, detyrim për zbatim nga OBU, merr masa për informimin e tyre përmes organizimit të takimeve të përbashkëta, si dhe organizimin e fushatave sensibilizuese.

Nga ana juaj, çfarë mbështetjeje konkrete po u jepet operatorëve? Bëhet fjalë vetëm për kontroll dhe penalitete, apo edhe për udhëzim teknik dhe asistencë, apo do të vihen në dispozicion bizneseve dhe fonde për të përmbushur investimet për sigurinë ushqimore?

Vlerësimi dhe kategorizimi realizohen nëpërmjet përdorimit të listave të verifikimit, të personalizuar sipas veprimtarive specifike për stabilimentet ushqimore. Listë-verifikimi do të plotësohet me komente në çdo rubrikë, pavarësisht nëse janë identifikuar mospërputhshmëri ose jo. Duke orientuar kështu OBU-të, mbi masat që duhet të marrin për përmirësimin e stabilimenteve.

Pasi të kemi rezultatet e plota, në një fazë të mëvonshme, për stabilimentet e kategorisë 3 do të përgatiten plane veprimi për korrjizimin e mospërputhshmërive.

AKU mbështetet në ekspertizën teknike të GIZ dhe projektit EUforFoodSafety, të cilët po asistojnë harmonizimin e procedurave, rritjen e standardeve, kapaciteteve dhe informimin.

A ka një plan të qartë masash për bizneset që nuk i plotësojnë standardet? Sa kohë u jepet realisht për përmirësim pas kategorizimit?

Kategoria 1: klasifikohen stabilimentet që ushtrojnë aktivitet në përputhje të plotë me kërkesat e BE-së.

Kategoria 2: klasifikohen stabilimente ku vihen re mospërputhshmëri të vogla që mund të zgjidhen gjatë një periudhe të shkurtër kohore (3-6 muaj).

Kategoria 3: klasifikohen stabilimente ku vihen re mospërputhshmëri të konsiderueshme (lidhur me planimetrinë, infrastrukurën e ndërimit, të cilat kërkojnë punime ose rinovime të mëtejshme dhe burime financiare të konsiderueshme ose stabilimentet që janë dekategoriuar nga kategoria 2) që mund të përmirësohen për një periudhë kohore më të gjatë se ajo e kategorisë 2.

Për këto stabilimente do të përgatiten plane veprimi për korrjizimin e mospërputhjeve në një fazë të mëvonshme.

Kategoria 4: klasifikohen stabilimente ku vihen re mospërputhshmëri madhore dhe stabilimenti:

- përbën rrezik të konsiderueshëm për shëndetin; nuk duhet të hedhë produkte në treg;
- duhet të mbyllet sepse nuk është në përputhje me legjislacionin kombëtar;
- nuk mund të arrijë standardet e BE-së.

Per kategorinë 4, AKU merr masa për mbylljen e stabilimentit.

Si po koordinoheni me institucionet e tjera dhe me programet e financimit (shtet apo BE) për të ndihmuar bizneset të arrijnë këto standarde?

Ky është një proces në vijim e sipër, në përfundim të të cilit do të përgatitet një plan veprimi për korrjizimin e mospërputhshmërive, duke përcaktuar dhe mekanizmat apo rolin e institucioneve bashkëvepruese.

Qeveria Shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshillit Ekonomik Kombëtar, si dhe projektit EUforFoodSafety, po hartojnë plane të mbështetjes financiare për bizneset dhe ngritje të grupeve të ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë për të asistuar procesin.

Vetëm 10-15% e bizneseve shqiptare janë të përgatitura për standardet e BE-së

Flet Arben Shkodra, Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës së Prodhuesve Shqiptarë

Për Arben Shkodrën, sekretarin e përgjithshëm të Shoqatës së Prodhuesve Shqiptarë, bazuar në një analizë paraprake të realizuar nga Ministria e Ekonomisë mbi vetëdeklarimet e bizneseve, vetëm rreth 10-15% e tyre konsiderohen të përgatitura për t'u bërë pjesë e tregut të Bashkimit Europian.

Z. Shkodra thotë se sektorët e përpunimit ushqimor dhe të ndërimit do të përballen me sfidat më të mëdha gjatë procesit të integritimit në BE.

Ai u kërkon të gjitha bizneseve shqiptare të nisin transformimin për të përmbushur standardet dhe për të rritur konkurrueshmërinë në tregun europian.



punimit industrial në BE.

Sektori i përpunimit industrial ndahet në dy nënsektorë: përpunimi industrial ushqimor dhe përpunimi industrial joushqimor. Pa dyshim që problemet më të mëdha do të hasen te nënsektori i përpunimit industrial ushqimor, pasi BE, me të gjitha standardet dhe kriteret teknike që vendos dhe kërkesat përkatëse, e ka fokusin te njeriu dhe siguria ushqimore e konsumatorit europian.

Në momentin e anëtarësimit të vendit në BE, çdo qytetar i Shqipërisë kthehet në konsumator të vendeve europiane dhe çdo konsumator europian që prek territorin shqiptar është pjesë e tregut europian dhe duhet t'i garantohet siguria ushqimore.

Në këtë kuadër, për 5-vjeçarin e ardhshëm jemi fokusuar në analizën dhe identifikimin e të gjitha instrumenteve mbështetëse që ne si Shoqatë e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë mund t'u japim anëtarëve dhe atyre që përfaqësojmë, në mënyrë që të jenë të mirinformuar dhe të mbrojtur, dhe më pas të propozojmë masa konkrete për institucionet, me qëllim që të kemi një integrim sa më të lehtë.

Çfarë keni konstatuar nga sondazhet paraprake? Si është situata me bizneset shqiptare, sa prej tyre arrijnë të përmbushin standardet e kërkuara?

Nga një analizë e Ministrisë së Ekonomisë, por edhe nga vlerësimet e kryera prej kohësh në terren, gjykojmë se sektori që do të goditet më shumë nga procesi i parë i certifikimit, i vlerësimit dhe i integritimit do të jenë degët e nënsektorit të përpunimit industrial ushqimor. Këtu përfshihen pijet alkoolike dhe joalkoolike, produktet ushqimore që prodhohen, tregtohen dhe përpunohen, si frutat, perimet, vaji i ullirit, brumërat, mishi dhe nënproduktet e tij, peshku etj.

Aktualisht, vëmendja kryesore e BE-së është identifikimi dhe vlerësimi i të gjithë sektorëve dhe nënsektorëve të industrisë ushqimore, me qëllim që ato të integrohen brenda standardeve ekonomike dhe të garantohet siguria ushqimore për konsumatorin europian.

Ne vlerësojmë që edhe nënsektori i përpunimit industrial joushqimor do të ketë mjaft probleme dhe kompanitë shqiptare duhet të nisin përgatitjen për plotësimin e standardeve, përfshirë standardet teknike për materialet e ndërimit.

Si materialet e ndërimit, ashtu edhe procesi i ndërimit, do të kalojnë në një filter shumë të dendur të BE-së, pasi duhet të garantohet që jo vetëm materialet të jenë të bazuara mbi eurokodet, por edhe procesi i ndërimit në Shqipëri të jetë i bazuar në rregulla shumë strikte.

Kjo do të thotë se ndërmarrjet vendase, qoftë të përpunimit industrial ushqimor, qoftë ato joushqimor, duhet të nisin punën për transformim të brendshëm. Fjalët kryesore për integrim janë: arritja e konkurrueshmërisë dhe transformimi. Pa transformim nuk mund të arrihet konkurrueshmëria.

Nga të dhënat paraprake, sa nga bizneset shqiptare i plotësojnë kriteret për standardet europiane?

Bazuar në një analizë paraprake të bërë nga Ministria e Ekonomisë sipas vetëdeklarimeve të bizneseve, rezultojnë se rreth 10 deri në 15% e tyre janë relativisht të përgatitura për të qenë pjesë e Bashkimit Europian. Rezultojnë një kategori tjetër ku përfshihen kompanitë që kanë probleme, por të zgjidhshme. Dhe është një tjetër kategori, ku përfshihet numri më i madh i bizneseve që nuk përmbushin asnjë standard teknik për të qenë pjesë e tregut europian, por që edhe nuk kanë dijeni sesi do t'i plotësojnë.

Si do të realizohet përmbushja e këtyre standardeve nga bizneset? A janë sipërmarrjet financiarisht në gjendje t'i përballojnë kostot?

Ndihma duhet të jetë e domosdoshme. Së pari, kompanitë duhet të marrin informacionin e nevojshëm dhe të ndërëgjegjësohen se ajo që po vjen është krejtësisht një situatë e re, nga

Ku është fokusuar Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë për të ndihmuar bizneset vendase për plotësimin e standardeve për integrim në tregun europian?

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian është një nga objektivat më madhorë, çka do të thotë se edhe organizatat e biznesit, në veçanti Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, janë të fokusuar në integrimin e sektorit të përpunimit industrial në BE.

modeli i biznesit që jemi mësuar deri tani.

Së dyti, bizneset duhet të bëjnë vetëvlerësim, që ka të bëjë me njohjen e standardeve, kriterëve dhe detyrimeve që duhet të plotësojnë. Duhet të vlerësojnë veten në çfarë niveli janë të përputhshmërisë me standardet.

Vetëvlerësimi duhet t'i çojë në një analizë kostoje, që do të thotë se për të arritur standardin mund t'u duhet ose të mbyllin kompaninë dhe të mendojnë një aktivitet tjetër, ose të llogarisin kostot dhe afatet për plotësimin e standardeve.

Nga ana tjetër, rol shumë të rëndësishëm në këtë proces duhet të luajë qeveria, e cila duhet të bëjë një vlerësim makro të boshllëqeve të degëve të caktuara të industrive dhe sektorëve dhe të fillojë t'i mbështesë nëpërmjet një programi të posaçëm për integrimin europian.

Duke parë strukturën e ndërmarrjeve në vend, ku 99% e kompanive janë mikrondërmarrje, 1 deri në 2% janë kompani të vogla dhe të mesme, 98% e biznesit nuk kanë mundësi reale monetare dhe kapacitetesh për të bërë transformimin, me qëllim arritjen e konkurrueshmërisë dhe mbijetesën në treg. Kjo do të thotë se duhet një vëmendje shumë e madhe te 98% e kompanive, për të parë se sa prej tyre mund të ndihmohen për t'u ngritur në nivelin e Bashkimit Europian.

Ndërsa për 2% e mbetur ka nevojë për orientim më të mirë nga qeveria dhe për rritje të nivelit të tyre në burime njerëzore dhe teknologjike, për të kaluar nga teknologjia 3.0 në teknologjinë 4.0 apo 5.0, si dhe për lehtësime procedurale për uljen e barrës administrative. Po ashtu, nevojitet edhe ndërveprim me qeverinë për inovacionin dhe kërkimin shkencor, duke rritur dialogun mes tyre.

Për çfarë referoheni kur thoni masa për uljen e barrës administrative?

Së pari duhet të rritet dialogu ndërmjet institucioneve publike dhe private, pasi gjatë tryezave të dialogut mund të dalin shumë çështje të zgjidhshme.

Bëhet fjalë për procedura administrative që ministrinë kanë me bizneset, që lidhen me lejet, licencat, autorizimet, hapjen e tregut, kriteret dhe procedurat e shtuara, si dhe tarifat.

Sa më shumë shërbime online të ofrohen për biznesin, aq më mirë është. Barra administrative nënkupton procedura të vendosura përmes ligjeve dhe akteve nënligjore, të cilat në disa raste krijojnë pengesa të panevojshme.

Pra, biznesit duhet t'i hiqen pengesat dhe procedurat e tepërta që nuk janë të nevojshme në kushtet e hapjes së tregut.

A do të duhet të orientohet biznesi drejt sektorëve të caktuar?

Patjetër që biznesi duhet të orientohet se cili do të jetë modeli ekonomik që do të kemi në Bashkimin Europian. A do t'i kemi të gjithë këta sektorë? Një orientim i tillë është shumë i rëndësishëm.

Biznesit duhet t'i jepet informacion i qartë, që sipas analizave të qeverisë dhe të tregut, disa sektorë mund të mos jenë shumë interesantë për të ardhmen.

Kjo i ndihmon bizneset ekzistuese të riorientojnë aktivitetin, por është gjithashtu një informacion shumë i vlefshëm edhe për sipërmarrësit e rinj, që të mos hyjnë në sektorë ku nuk ka shanse mbijetese në tregun e Bashkimit Europian.

Nga ana tjetër, qeveria duhet të bëjë përpjekje maksimale për të mbështetur prodhimin vendas, siç është rasti i markës "Made in Albania", përmes promovimit dhe nxitjes së prodhimit, pa pasur domosdoshmërisht nevojë për ulje taksash.

Sa është afati për arritjen e këtyre standardeve?

Deri në vitin 2030 kemi kohën për të realizuar këtë transformim. Më pas hyjnë në fuqi direktivat e Bashkimit Europian, që do të thotë se Shqipëria bëhet pjesë e BE-së dhe të gjitha kompanitë duhet të kenë përmbushur kriteret nëse duan të qëndrojnë në treg.

Bizneset kanë edhe rreth tre vite kohë dhe ekonomia shqiptare ka mundësi të shpëtojë një pjesë të konsiderueshme të tyre, duke i bërë të denja për tregun europian. Në të kundërt, kompanitë që nuk përmbushin standardet do të dalin nga tregu.

Tregu nuk do të mbetet bosh, ai do të zëvendësohet nga kompani të tjera europiane, duke sjellë edhe një konkurrencë të fortë në tregun vendas, por edhe "pushtim" të ri ekonomik të vendit.

Nga Dorina Azo

INFORMACIONE

Shqipëria 49 milion euro nga fondi i BE për planin e rritjes, Haçkaj: I përkasin klimës së biznesit dhe fushave që lidhen me grupkapitujt

Shqipëria ka arritur disbursimin e 49 milionë eurove nga totali 200 milionë për rajonin që vendosi së fundmi Komisioni European. Autoritetet në ekspertizën e kësaj

quar, le të themi, këtë fushë në fushën e politikave në kuadër të planit të reformës që ka performuar më mirë. Me përqindje do të thosha gati në 28% arritje, pra gati 1/3 e masave

tranzicionin në fushën e transformimit dixhital, një në fushën e tranzicionit energjetik dhe të axhendës së gjelbër dhe dy në fushën e sundimit të ligjit”, theksoi ekspertja.

Ajo që ekspertja e integritetit vlerëson është fakti që 9 reforma lidhen direkt me kapitujt e bisedimeve.

“Gati nëntë prej tyre kontribuojnë direkt në piketat përfundimtare të kapitujve. Pra jemi tani në fazën që ne po diskutojmë aprovimin e raportit të piketave të ndërmjet ai që njihet me termin IBAR. Por paralelisht ka filluar puna për përmbylljen e piketave përfundimtare. Pra, agjenda e reformave në një farë mënyre është edhe një instrument




fushe, Krisela Haçkaj i pohoi Televizionit Publik se arritja i përgjigjet performacës së deritanishme më të mirë që ka bërë Shqipëria përkundrejt vendeve të tjera në rajon.

“Në raportin e dytë që Shqipëria ka çuar në Komisionin European në janar të vitit 2026, ne kemi arritur të përthithim, le të themi, gati 49 milion euro. Pra, jemi gati në 25% do të thosha të realizuar, 1/4 pra pak a shumë e realizuar në kuadër të detyrimeve që ne kemi për axhendën e reformave”, tha Haçkaj.

Fondet e miratuara për lëvizim i përkasin në masën më të lartë klimës së biznesit.

“12 masa reformuese që i përmenda, pesë nga të cilat i përkasin përmirësimit të klimës së biznesit, duke e



të parashikuara në politikën ose në fushën e politikave që quhet të përmirësimit të klimës së biznesit të arritur. Kemi gjithashtu aprovimin e dy hapave që kanë të bëjnë me kapitalin njerëzor. Dy hapave të tjera që kanë të bëjnë me

mbështetës dhe shpejtues i punës së qeverisë, pra institucioneve që kanë përgjegjësi në kuadër të planit të reformave për të ecur edhe më shpejt në drejtimin të përmbylljes së kushteve përfundimtare”, deklaroi ekspertja.

Regjistrimi fillestar, drejt përfundimit procesi në 108 fshatra nga Elbasani në Vermosh

Agjencia Shtetërore e Kadastrës njofton se po shkon drejt përfundimit procesi i Regjistrimit Fillestar në 108 fshatra, në një shtrirje territoriale që nis nga Elbasani dhe përfundon në Vermosh.

Sipas ASHK-së, puna në terren tashmë është kryer plotësisht, duke përfshirë matjen e çdo parcele, pasqyrimin e çdo objekti dhe administrimin e dokumentacionit të pronësisë në bashkëpunim me banorët e zonave përkatëse.

ASHK bën me dije se gjatë fazës së afishimit, të gjitha të dhënat janë bërë publike në njësitë administrative, në drejtoritë vendore, si edhe në platformën online të Regjistrimit Fillestar në ASHK, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.

Sipas njoftimit, brenda muajit qershor, të 108 fsha-

trat do të pajisen me Regjistër Kadastral të plotë.

Ky proces konsiderohet një hap konkret drejt forcimit të

sigurisë juridike të pronës, si edhe avancimit të reformave të lidhura me procesin e integritetit evropian të Albanisë.



Rama: Programi “Dyfisho sipërmarrjen tënde”, mundësi konkrete për mijëra biznese

Kryeministri Edi Rama deklaroi se partneriteti i ri ndërmjet shtetit, sistemit bankar dhe sipërmarrjes shqiptare për programin “Dyfisho sipërmarrjen tënde” përbën një hap të rëndësishëm për mbështetjen dhe zgjerimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vend.

Në podkastin “FLASIM”, Rama u ndal te nënshkrimi i partneritetit të ri mes qeverisë, sistemit bankar dhe Bankës së Shqipërisë për programin

iptare”, u shpreh Rama. Kryeministri theksoi se programi krijon më shumë akses për bizneset e vogla dhe të mesme në financim, përmes kredive me interesa të ulëta dhe garancisë sovraane të qeverisë.

“Nënshkrimi i partneritetit ndërmjet qeverisë, sistemit bankar dhe linjës së kredisë së Bankës së Shqipërisë për programin kombëtar të financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është një derë e hapur,

nevoja tanimë gjithmonë e më e zëshme e sipërmarrjes së vogël shqiptare për t’u rritur në bazë të themeleve të hedhura me shumë punë, me shumë përpjekje, me shumë mund dhe, në shumë raste, me eksperiencën e fituar në emigracion”, tha Rama.

Kryeministri vlerësoi energjinë dhe potencialin e sipërmarrësve shqiptarë, duke theksuar nevojën që shteti të jetë në mbështetje të tyre.

“Njerëz me ide, njerëz me energji, me vullnet kanë nevojë të kenë shtetin në krah, të kenë qeverinë në krah për ta zgjeruar aktivitetin e tyre, pasi për të riinvestuar duhet një financë që ata për të nuk e kanë, por nga ana tjetër kanë në dorë një zanafillë që mund ta kthejë atë financim të kredituar në një sukses komercial plotësisht të arsyeshëm për kreditin mbështetës”, u shpreh ai.

Rama theksoi se përmes këtij programi pritet të mbështeten mijëra ndërmarrje shqiptare përmes normave të favorshme të interesit dhe garancive sovraane.

“Kështu që, përmes këtij programi, ne besojmë shumë që, duke vënë në dispozicion një linjë kredie me interesa nga 2 deri në 3% dhe një garanci sovraane nga 30 deri në 70%, në bazë të riskut, do t’u japim mundësi të mëdha konkrete mijëra ndërmarrjeve shqiptare”, deklaroi kryeministri.



kombëtar të financimit të sipërmarrjeve.

“Këtë javë nënshkruam edhe partneritetin shumë të rëndësishëm mes shtetit dhe sistemit bankar për mbështetjen e sipërmarrjes shqiptare. U hodh një hap i paralajmëruar, por që është një hap në drejtimin e duhur me një potencial të jashtëzakonshëm për rritjen e mëtejshme të sipërmarrjes shq-

një program që u jep shumë më tepër mundësi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që të rriten përmes kredive me interesa të ulëta dhe garancisë sovraane të qeverisë për kreditin e tyre”, deklaroi Rama.

Sipas tij, programi është ndërtuar mbi kërkesën në rritje të sipërmarrjeve shqiptare për zgjerim dhe investime të reja.

“Një program i lindur nga

“Egnatia Fest 2026” çel sezonin turistik në Librazhd

Librazhdi çeli sezonin turistik me aktivitetin “Egnatia Fest 2026”, të organizuar në Parkun e Qershive, ku morën pjesë rreth 54 biznese të ndryshme që promovuan natyrën, historinë, traditën dhe potencialin turistik të zonës.

I pranishëm ishte edhe ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, i cili vlerësoi rëndësinë e promovimit të turizmit lokal dhe rolin të sipërmarrjeve në zhvillimin ekonomik të zonës.


“Ka potencial në rritje. Paka e Maleve ka numër të konsiderueshëm aplikantësh për të investuar në këtë zonë. Duke qenë se Korridori i 8 kalon ngjitur me Librazhdin, destinacioni i radhës do jetë ky. Bashkia Librazhd po punon shumë mirë duke vënë në dispozicion të gjitha mundësitë dhe mbështetjen për sektorin privat. Po investojmë në këtë fushë me Ministrinë e Turizmit dhe të Bujqësisë. Po përafrojmë legjislacionin për agroturizmin që të shtohen agroturizmet dhe të lehtësojmë procedurat për ta dhe të ndihmojmë në cer-

tifikimin e tyre”, tha ministri Salla.

Kryebashkiaku i Librazhdit, Mariglen Disha vuri në dukje se vitin e kaluar Librazhdi dhe zonat me potencial turistik si Fushë Studen apo edhe pjesë

të gjitha resurset turistike. Këtu mendojmë që deri në fund të vitit të kemi mbi 300.000 turistë” tha Disha.

Aktiviteti shërbeu si një panair promovues i produkteve dhe shërbimeve lokale, duke



të rrugës “Egnatia” e vizituan 192 mijë vizitorë vendas dhe të huaj.

“Bashkia Librazhd do të vazhdojë të investojë në infrastrukturë sepse paralelisht me rikonstruksionin e rrugëve ne zhvillojmë dhe turizmin malor. Kemi bërë një punë shumë të mirë duke promovuar

bashkuar biznese të gastronomisë, agroturizmit dhe artizanatit, si dhe duke sjellë në vëmendje potencialin turistik të Librazhdit.

“Egnatia Fest 2026” synon të kthehet në një traditë që mbështet zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë lokale gjatë sezonit veror.

INVESTIME

Nga banka, tek “ari i kuq”, Balla viziton fermën me mjedra të Manjolës në Fushë-Prezë

Drejtesi politik i Partisë Socialiste për qarkun Tiranë, Taulant Balla, së bashku me kryetarin e bashkisë Vorë, Blerim Shera, vizituan në Fushë-Prezë një nga historitë më frymëzuese të sipërmarrjes rurale në zonën e Vorës, fermën e ndërtuar nga Manjola Hafizi, vajzës që la pas një karrierë të shkëlqyer në sektorin bankar për t'iu përkushtuar bujqësisë moderne dhe kultivimit të mjedrës, e njohur ndryshe si “ari i kuq”.

Në zemër të fermës së saj, mes serrave dhe parcelave të mbjella me kujdes, Manjola rrëfeu sfidat dhe sukseset e rrugëtimit të saj, duke treguar se si pasioni për tokën dhe dëshira për të ndërtuar diçka të qëndrueshme e shtynë të merrte vendimin e madh për të ndryshuar jetën.

Gjatë vizitës, Balla vlerësoi modelin e sipërmarrjes së re në bujqësi, duke theksuar se histori të tilla janë shembulli më i mirë se si të rinjtë shqiptarë mund të investojnë dhe të ndërtojnë të ardhmen në vendin e tyre.

“Historia e Manjolës është frymëzim për shumë vajza dhe djem të rinj. Kur pasio-



ni bashkohet me punën dhe mbështetjen për bujqësinë, lindin histori suksesi si kjo fermë moderne në Fushë-Prezë”, u shpreh Balla.

Balla gjithashtu theksoi rëndësinë që ka mbështetja ndaj fermerëve dhe agroturizmit në zonë, duke nënvizuar

se investime të tilla po i japin zhvillim ekonomik dhe punësim komunitetit lokal.

Mjedra, e cilësuar shpesh si “ari i kuq” për vlerën e saj të lartë në treg, po kthehet në një kulturë me potencial të madh për eksport dhe zhvillim ekonomik, ndërsa ferma e Manjolës mbetet një shembull se si guximi për të ndjekur ëndrrat mund të sjellë sukses.

Marrëveshje me Turqinë për forcimin e kapaciteteve në menaxhimin e fondeve IPARD

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) dhe Institucioni Mbështetës për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural i Turqisë (TKDK) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për forcimin e shkëmbimit të përvojës dhe rritjen e kapaciteteve në menaxhimin e fondeve IPARD.

Marrëveshja është nënshkruar në kryeqytetin turk Ankara, ndërmjet drejtoreshës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) Ardita Kuçi dhe drejtorit të Agjencisë për Mbështetjen e Zhvillimit Rural të Turqisë (TKDK), Ali Recep Nazlı.

Marrëveshja synon shkëmbimin e praktikave më të mira në administrimin e fondeve, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e proceseve të zbatimit të pro-

grameve mbështetëse për zhvillimin rural.

Ky bashkëpunim vlerësohet si një hap i rëndësishëm drejt



Kuçi tha se, një vëmendje e veçantë i kushtohet rritjes së eficiencës në përthithjen e fondeve IPARD, përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta për stafet përkatëse.

forcimit të standardeve dhe rritjes së ndikimit të fondeve në mbështetje të fermerëve dhe sipërmarrjeve rurale në vend, në kuadër të përafrimit me standartet e Bashkimit Europian.

EU4Trade, mbështetje rritjes së standardeve në prodhimin e fidanëve në Shqipëri dhe Kosovë

Bashkimi Europian po mbështet Shqipërinë dhe Kosovën në rritjen e standardeve në prodhimin dhe monitorimin e shëndetit të bimëve përmes projektit “EU4Trade”.

Në këtë kuadër, këtë fundjavë në Prizren u zhvillua takimi i përbashkët i inspektorëve nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes së Bimëve, si dhe nga Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të Shqipërisë dhe Kosovës.

Gjatë trajnimit u prezantuan praktikat dhe metodologjitë bashkëkohore të monitorimit dhe kontrollit fitosanitar të fruta-perimeve, me synim përmirësimin e standardeve të prodhimit dhe forcimin e sigurisë së produkteve bimore.

Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e harmonizimit të

Ky takim u vlerësua nga specialistët si një kontribut



procedurave me standartet e Bashkimit Europian, si një hap i rëndësishëm për rritjen e cilësisë së prodhimit dhe lehtësimin e tregtisë rajonale.

i rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së bimëve.

Krijohet Fondi i Gjelbër, një pemë për çdo tavolinë në hapësira publike

Këshilli i Ministrave ka miratuar krijimin e Fondit të Gjelbër të Pemëve, në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit dhe rritjen e sipër-

për nevoja publike dhe peizazh urban.

Vendimi përcakton se çdo subjekt që pajiset me leje ndërtimi do të ketë detyrimin

e prodhimit të energjisë parashikohet mbjellja e 10 pemëve për çdo megavat kapacitet.

Vendimi parashikon gjithashtu detyrime edhe për subjektet që shfrytëzojnë hapësira publike.

Çdo person fizik apo juridik, që pajiset me leje nga njësia e vetëqeverisjes vendore për shfrytëzimin e hapësirave publike do të duhet të kontribuojë me një pemë për çdo tavolinë ose të paguajë ekuivalentin financiar në fondin e gjelbër të bashkisë përkatëse.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore do të jenë përgjegjëse për identifikimin e hapësirave për mbjellje, zbatimin e pemëve, ndërsa Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit do të krijojë regjistrin elektronik të fondit në sistemin e-Leje.

Për zbatimin e vendimit ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Vendimi hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.



faqeve të gjelbëruara në vend.

Sipas vendimit, fondi do të funksionojë si fond fizik i përbërë nga fidanë dhe pemë për mbjellje dhe do të administrohet në nivel qendror nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit.

Fondi do të përdoret për integrimin e elementeve të gjelbërimit në zhvillimin urban, rritjen e hapësirave të gjelbëruara, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përdorimin e pemëve

të kontribuojë në fond përmes mbjelljes së pemëve.

Për objektet rezidenciale dhe turistike parashikohet mbjellja e një pemë për çdo 30 metra katrorë sipërfaqe ndërtimi, por jo më pak se 20 pemë për kat dhe jo më shumë se 500 pemë për çdo leje ndërtimi.

Ndërkohë, për vilat dhe shtëpitë individuale kërkohet mbjellja e 10 pemëve, po aq edhe për magazinat bujqësore dhe industriale. Për centralet

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ka nisur procesin e kategorizimit dhe vlerësimin për sigurinë ushqimore, për produktet me origjinë shtazore, qumështi, mishi, peshku dhe veza, si një masë për të përmbushur standartet e sigurisë së kërkuara nga procesi i integritetit në BE.

Drejtoresha e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) Blerina Gjylameti tha në konferencën e parë Kombëtare të Industrisë së Për-

AKU: 253 operatorë ushqimi në proces vlerësimi dhe kategorizimi

punimit të Qumështit se pas një skanimit që i është bërë sektorëve kanë nisur inspektimet nga trupa e AKU në stabilimentet dhe fabrika.

“Do të verifikohen 253 operatorë për të parë se ku jemi. Në listë, verifikimet e inspektorëve do të përfshijnë komente të detajuara për të identifikuar

ndryshimet e nevojshme. Në fund të raportit do të kemi të qartë se çfarë duhet të ndryshojë”, deklaroi ajo.

Gjylameti rikonfirmoi angazhimin e institucionit për përmbushjen e standardeve europiane të sigurisë ushqimore, duke e cilësuar këtë proces si pjesë të strategjisë

kombëtare.

Konferenca shërbeu si një platformë bashkëpunimi mes industrisë dhe institucioneve, duke vënë theksin te rritja e cilësisë, sigurisë ushqimore dhe forcimi i kontrollit në zinxhirin e prodhimit dhe përpunimit të qumështit në vend.



BUJQËSI

Rama: Mbështetja për dyfishimin e SME-ve, garanci për vende të reja pune

Kryeministri Edi Rama mori pjesë në firmosjen e marrëveshjes për linjën e re të financimit ndërmjet Bankës Evropiane të Investimeve dhe Intesa Sanpaolo Bank Albania, për të mbështetur bizneset e vogla e të mesme shqiptare në inovacion, digitalizim, teknologji dhe investime të gjelbra.

Në fjalën e mbajtur në këtë ceremoni, Kryeministri siguroi se qeveria do të bëjë gjithçka është e mundur për të mbështetur të gjithë ata njerëz që i besojnë sipërmarrjes së lirë dhe ndërmarrjeve të tyre të vogla e të mesme.

“Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë partnerët tanë më të rëndësishëm në krijimin e vendeve të punës për të mbështetur familjet dhe sigurisht për të krijuar hapësirë për të rinjtë që të rriten”, u shpreh Rama.

Duke folur për marrëveshjen e firmosur, Rama theksoi se ajo synon të mbështesë programin e madh për dyfishimin e sipërmarrjeve të vogla e të mesme.

“Ajo çfarë e bën të rëndësishme këtë hyrje të Bankës Evropiane të investimeve së bashku me bankën Intesa San-

sapo është krijuar, është një instrument i ri që do të shërbejë si urë midis qeverisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve.



paolo nuk është thjesht vlera e parave. Është mundësia për të bërë maksimumin për të përfituar prej tyre përvojën që kanë krijuar në kaq shumë vite në mbështetje të shteteve anëtare”, u shpreh Rama.

Kryeministri theksoi se Banka Shqiptare e Zhvillimit që

“Po pres me padurim që të forcojmë bashkëpunimin me Bankën Evropiane të Investimeve. Së pari për të marrë sa më shumë të jetë e mundur nga dija juaj e jashtëzakonshme dhe së dyti sigurisht për t’ju bërë të investoni më shumë në Shqipëri”, shtoi Rama.

Lehtësi për turistët dhe sfidë për bizneset, pajisjet POS bëhen të detyrueshme në turizëm, 31 Maji afati i fundit

Sipërmarrjet në fushën e turizmit do të kenë afat deri në fund të muajit për të zbatuar detyrimin ligjor për kryerjen e pagesave pa para në dorë përmes pajisjeve POS në pikat e shitjes.

Për Flori Ukën sipërmarrës, pagesat “cashless” janë një lehtësi e madhe për turistët dhe vizitorët e huaj.

“Nëse ne i ofrojmë pagesat me cash si formë pagese, kjo është sigurisht më stresuese për klientin, pasi duhet të bëjë vetë kursin e këmbimit dhe shpesh ka edhe dyshime nëse pagesa është kryer saktë apo plotësisht. Prandaj, pagesat me bankë janë një domosdoshmëri për të plotësuar ofertën turistike, të cilën

ne tashmë e kemi mjaft të çmuar”, u shpreh Uka.

Zbatimi i kësaj nisme mbetet sfidë për bizneset e vogla.

“Strukturat akomoduese të konsoliduara e kanë tashmë të integruar në punën e tyre këtë praktikë, por sfida mbetet më e madhe tek bizneset e vogla, si bujtinat familjare, si edhe në zinxhirin e shërbimeve të tjera në nivel komuniteti”.

Nga ana tjetër komisionet për përdorimin e POS-eve mbeten një pengesë për tu adresuar.

“Është një komision shumë i lartë. Ky lloj komisionit për operatorët më të vegjël është ndoshta pengesa më kryesore”.

Formalizimin e turizmit, Flori Uka e sheh të lidhur ngushtë edhe me sektorë të tjerë të ekonomisë.

“Bujqësia është ende informale dhe kjo përbën një handicap shumë të madh për ekonominë shqiptare, sepse është e lidhur drejtpërdrejt me turizmin dhe me furnizimin me lëndë të parë cilësore. Në të njëjtën kohë, ajo i mban njerëzit në vend, duke mos i detyruar të emigrojnë”, theksoi Uka.

Nga ana tjetër Drejtoria e Tatimeve bën të ditur se me mbarimin e afatit, subjektet që nuk janë pajisur me sistemet e kërkuara do të përballen me masa administrative sipas legjislacionit në fuqi.

Dita Botërore e Bletës, bletarët apel për mbrojtjen e saj, simbol i jetës në ekosistem

20 maji shënon Ditën Botërore të Bletës, një ditë ndërgjegjësimi për rëndësinë që kanë bletët në jetën dhe ekosistemin tonë. Bletarë të shumtë vijojnë të ruajnë këtë traditë të lidhur ngushtë me natyrën. Një prej tyre është edhe Ylli Matija, rruga e tij pranë bletëve nisi vite më parë dhe u kthye në një pasion që vazhdon edhe sot.

Puna me bletët kërkon kujdes të vazhdueshëm, përkushtim dhe njohje të detajuar të këtij procesi.

Në Ditën Botërore të

Bletës vëmendja rikthehet tek mbrojtja e tyre dhe rëndësia që kanë për mjedisin.

“Të qenit veteriner më ka ndihmuar sepse njihja një pjesë të sëmundjeve të bletës por dashuria për bletën vjen e para. Nëse nuk do bletën nuk mund të bëhesh një bletar i suksesshëm”, u shpreh Ylli Matija, Bletar, mjek veteriner.

Në Ditën Botërore të

Bletës vëmendja rikthehet tek mbrojtja e tyre dhe rëndësia që kanë për mjedisin.

“Me skalitjen më të mrekullueshme të natyrës pjesën më të madhe e ka bleta në dorë”, tha ai.

Me përvojën e krijuar ndër vite Ylli Matija vijon të mbetet pranë bletëve duke e konsideruar këtë rrugëtim një lidhje të veçantë me natyrën dhe jetën.

Qumështi, a do të hapë kategorizimi dyert e eksporteve? - Zv.Ministrja Kika: Subjekteve u janë lënë afate për plotësimin e standardeve

Rreth 900 operatorë të biznesit në industrinë e qumështit do të kalojnë filtrin e standardeve, me qëllim që të përmbushin kërkesat e integritit në BE, por edhe të mund të eksportohen sa më shpejt.

Në një intervistë për SCAN TV, Zv.Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Tana Kika, shprehet se aktualisht ka përfunduar faza e parë e kategorizimit për 253 subjekte.

“Është një përmbledhje e të gjithë situatës aktuale dhe një pikëzim sipas kategorive që ata plotësojnë në lidhje me kriteret, kushtet e operatorëve të biznesit ushqimor. Siç janë standardet e higjienës, apo dhe elementë të tjerë siç është HAÇP-ja, apo çështje infrastrukturore. Dhe, tek bëhet ky kategorizim, operatorëve të biznesit ushqimor gjithashtu iu lihen detyra të qarta, dhe afate kohore të caktuara për përmbushjen e këtyre detyrimeve, të cilat ata duhet t’i arrijnë për të arritur objektivat dhe për të kaluar në një kategori të mësipërme, apo dhe për ta, për t’u kategorizuar si

OBU ose operatorë të biznesit ushqimor që i plotësojnë kriteret. Patjetër që është shumë i nevojshëm katego-



rizimi, jo vetëm se është një panoramë dhe një situatë reale, për vlerësimin e sektorit, dhe në këtë mënyrë ne mund të bëjmë një plan veprimi më pas për të shkuar të gjithë së bashku drejt përmbushjes së këtyre standardeve, pra për të zbatuar detyrimet ligjore”.

Sipas Zv.Ministres, ky proces do të ndikojë jo vetëm në rritjen e sigurisë ushqimore, por edhe në hapjen e dritës jeshile

të eksporteve për produktet e bulmetit.

“Puna deri tani vijon. Për shembull, neve jemi shumë

afër hapjes së eksportit të vezës, kategorisë A, ose vezës së tavolinës, vezës shqiptare. Kështu do të vijohet dhe me qumështin, mishin, jo vetëm për të garantuar konsumatorin vendas, por sigurisht dhe për të pasur akses në tregjet europiane.”

Aktualisht, Shqipëria nuk eksporton produkte shtazore për shkak se nuk plotëson standardet e Bashkimit Europian.

“Porta e Alpeve”, investimi 50 milionë euro i BEI për transformimin e infrastrukturës dhe turizmit në veri

Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat ratifikoi marrëveshjen financiare me Bankën Evropiane të Investimeve (BEI), që i hap rrugë financimit të projektit “Porta e Alpeve”, një nga investimet më



misë lokale dhe reduktimin e pabarazive rajonale.

“Projekti ‘Porta e Alpeve’ konsiderohet një ndërhyrjet strategjike për rritjen e aksesit në zonat veriore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm,

të rëndësishme infrastrukturore për veriun e vendit. Gjatë prezantimit të projektit, zëvendësministri i Financave, Endrit Yzeiraj, e cilësoi “Portën e Alpeve” si një ndërhyrje strategjike për zhvillimin ekonomik dhe turistik të Shqipërisë së Veriut.

misë lokale dhe reduktimin e pabarazive rajonale.

“Projekti ‘Porta e Alpeve’ konsiderohet një ndërhyrjet strategjike për rritjen e aksesit në zonat veriore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm,

misë lokale dhe reduktimin e pabarazive rajonale.

“Projekti ‘Porta e Alpeve’ konsiderohet një ndërhyrjet strategjike për rritjen e aksesit në zonat veriore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm,

misë lokale dhe reduktimin e pabarazive rajonale”, u shpreh Yzeiraj gjatë raportimit në komision.

Ai sqaroi se marrëveshja me BEI parashikon kushte financiare të favorshme, me norma të ulëta interesi dhe periudha të gjata shlyerjeje, duke e bërë investimin të përballeshëm për financat publike.

Deputetët e Komisionit u ndalën te fazat e zbatimit të pro-

jektit, ndikimi në zhvillimin e turizmit dhe efektet financiare të huasë për buxhetin e shtetit.

Nga ana e saj, kryetarja e Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, Milva Ekonomi, theksoi se projekti përfaqëson një investim strategjik për Shqipërinë e Veriut dhe për zhvillimin e turizmit gjithëvjetor.

Sipas Ekonomit, marrëveshja me Bankën Evropiane të Investimeve parashikon një financim prej 50 milionë eurosh për infrastrukturën bashkiake dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në veri të vendit.

Ajo bëri të ditur se projekti synon të lidhë Alpet Shqiptare me bregdetin Adriatik përmes investimeve në rigjenerimin urban, përmirësimin e rrugëve dhe mobilitetit të qëndrueshëm, krijimin e shtigjeve turistike dhe korsive të biçikletave, si dhe zhvillimin e hapësirave publike dhe produkteve të reja turistike.

“Ky është një hap i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, nxitjen e turizmit gjithëvjetor dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetet e Shqipërisë së Veriut”, u shpreh Ekonomi.



Agro Invest



Agrokredia

Norme efektive deri në: 3.5%

Financimi: Deri në 25.000.000 LEKË

Afati: Deri në 5 vite

Skano për
më shumë

